AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë "Bachelor"në**

**"Mësuesi për Arsimin Fillor"**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë**


Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1.Dr.Dilina Beshiri

2.Dr.Robert Gjedia


Prill, 2021

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Për Programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor"**

| Nr. | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Edukimit |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | VMASh Nr. 143, datë 04.8.1998 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | Vendim Senati Nr. 9/8, datë 06.07.2009 |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | UMASh Nr. 439, date 09.09.2011 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i parë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 vite/6 semestra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 180 kredite |
| 11 | Forma e studimit: | Kohë e plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 6 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 19 PAE/ 6 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | 62 |
| 19 | Komente / të tjera: | |

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Në kuadrin e akreditimit të programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor", kërkuar nga Institucioni i Arsimit të Lartë, Universiteti "Ismail Qemali "Vlorë, është realizuar procesi respektiv i vlerësimit, duke u bazuar fillimisht në aktivitetet e realizuara, sipas agjendës së miratuar nga dy institucionet. Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet që kanë dalë si rezultat i analizës për procesin e vlerësimit të jashtëm.

Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm është programi i studimit me kohë të plotë i ciklit të parë "Bachelor", me emërtesë "Mësuesi për Arsimin Fillor" i ofruar nga Departamenti i Edukimit. Ky departament është pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane.

Programi i studimit është hapur me Urdhër MASH nr.143, datë 04.08.1998. Urdhëri përkatës e ka licencuar si program i ciklit të parë "Bachelor".
Forma e regjistrimit të diplomës: Urdhëri i MASh Nr. 439, date 09.09.2011
Programi i studimit nuk ka kaluar më parë proces akreditimi.

Ky program i ciklit të parë "Bachelor" përmban gjithsej 180 ECTS dhe është me kohëzgjatje normale 3 vite akademike. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program ndër vite ka qenë:

- Për vitin akademik 2019-2020 është 5 studentë
- Për vitin akademik 2018-2019 ka qënë 12 studentë
- Për vitin akademik 2017-2018 ka qënë 45 studentë

Ky program studimi akreditohet për herë të parë.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

*Metodologjia e përdorur për realizmin e vlerësimit të jashtëm*

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr. 531, datë 11.09.2018, për programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor". ASCAL bazuar në "*Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017*", ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës (UV)-Fakulteti i Shkencave Humane (FSHH), për të realizuar takimet në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Dr.Dilina Beshiri, Dr.Robert Gjedia dhe gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Msc. Aviola Bardhi.

***Baza ligjore mbi të cilin është mbështetur procesi i vlerësimit të jashtëm* është:**

- Ligji nr.80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
- Urdhër i MASH nr. 81, datë 25.02.2013
- VKM nr. 531, datë 11.09.2018 "Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë"
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017.

***Aktivitet kryesore të realizuara***

Në kuadër të këtij vlerësimi janë realizuar disa aktivitete. Kështu, është realizuar analiza e të dhënave parësore dhe dytësore.

**Analiza e të dhënave parësore**. Të dhënat parësore janë ekstraktuar nga raporti i vlerësimit të brendshëm për programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor" (2019) i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm, Statuti i UV, Rregullore e UV, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane, paketa e plotë e dokumentacionit të programit, programet lëndore, si dhe dokumentacione të tjera administrative, siç është dokumentacioni i personelit.

**Analiza e të dhënave dytësore**. Analiza e të dhënave dytësore u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara me anë të Platformës Zoom. Si rezultat i shtrirjes së efektit të Pandemisë prej COVID-2019, si edhe në kuadër të zbatimit të protokollit të përcaktuar nga Komisioni Teknik i Ekspertëve në Republikën e Shqipërisë, si edhe nga aktet normative në fuqi, vizitat e planifikuara në ambjentet e UV (Fakulteti të Shkencave Humane, Departamentit të Edukimit) nuk u zhvilluan në kushtet e pranisë fizikë në institucion, por përmes realizimit të takimeve online, përmes përdorimit të platformave të konsoliduara me format video dhe audio me përdorim të gjërë për këtë qëllim. Takimet sipas agjendës së paracaktuar dhe të dakordësuar nga të dy institucionet janë zhvilluar në datat 11 dhe 12 Shkurt 2020. Gjatë këtyre takimeve u zhvilluan bashkëbiseda të qëllimta dhe vëzhgime. Kështu, u realizuan biseda të drejtuara me Drejtuesin e Njësisë Qëndrore; bisedë me Përgjegjësin e Departamentit të Edukimit, Përgjegjës për programin "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor", bisedë me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, bisedë me stafin akademik të programeve të studimit; bisedë me përfaqësues të Drejtorisë së Edukimit,

dhe Promocionit; bisedë me përfaqësues të studentëve të programit të studimit "Mësuesi për Arsimin Fillor"; bisedë me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit.

**Vëzhgimi i mjediseve**

Siç u cilësua më sipër, si rezultat i pandemisë prej COVID-19, vizitat në institucion nuk janë realizuar në prezencë fizike. Stafi i "UV", ka patur gjatë gjithë kohës një përkushtim maksimal për t'i siguruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të gjithë elementët e nevojshëm për ta kaluar këtë pengesë. Kështu, anëtarë të stafit me anë të përdorimit të mjeteve teknologjike audio-vizuale, mundësuan vëzhgime mjaft cilësore të auditorëve, të laboratorëve të informatikës, të sekretarisë, si edhe të ambjenteve të bibliotekës.

Duke u mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime është hartuar dhe raporti i vlerësimit të jashtëm.

Më datë 19.03.2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare 1/22 prot, datë 19.03.2021 dërgohet në Institucion Draft- Raporti i vlerësimit të jashtëm. IAL përcolli komentet përmes AMS më datë 02.04.2021 dhe me shkresë zyrtare Nr 490/2 Prot, datë 02.04.2021.

**GVJ pasi u njohën me komentet e institucionit mbi Draft- Raportin sqaron si vijon:**

- **STANDARDI V.5**

__Kriteri 2:__ Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.

**GVJ ndër të tjera komenton***:* "Ndërsa përsa i përket përfshirjes se studentëve në vendimmarrje e këshillim rezulton se institucioni nuk disponon asnjë dokument, që të vërtetojë pjesëmarrjen e studentëve në Senatin Akademik dhe Këshillin e Etikës".

**Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP argumenton:** Studentët janë në fokus të Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit dhe si rrjedhim, angazhimi i tyre në proçeset e vendimarrjes, këshillimit apo vlerësimit të institucionit është i vazhdueshëm. Dokumentat, të cilat dëshmojnë pjesëmarrjen e studentëve në Senatin Akademik dhe Këshillin e Etikës:

- Vendimin e Senatit Akademik nr. 40 datë 29.01.2020 " Për Përzgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit të Etikës në Universitetin " Ismail Qemali", Vlorë"[1]. Në Këshillin e Etikës njëri prej anëtarëve është student.
- Vendimin e Senatit Akademik nr. 79 datë 08. 09. 2020 " Për Kostituimin e Senatit Akademik të Universitetit " Ismail Qemali", Vlorë"[2]. Në Senatin Akademik janë anëtarë dy studentë.

[1] Vendim Senati nr. 40, datee 29.01.2020, publikuar ne faqen zyrtare te Universitetit: https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2020/02/Vendim-Nr.-40-Dt.-29.01.2020.pdf

Përveç garantimit të përfaqësisë së studentëve në organet kolegjiale të sipërpërmendura në UV studentët janë dhe pjesë e pandarë e komisioneve të ndryshme Ad-Hoc të ngritur me qëllim hartimin apo përmirësimin e instrumenteve për sigurimin e cilësisë në UV[3],[4],[5],[6],[7] apo komisioneve për përzgjedhjen e fituesve të bursave Erasmus+[8].

**Përgjigjja GVJ:**
GVJ pasi shqyrtoi dokumentet e publikuara në faqen zyrtare të UV, konstaton se Vendimi i Senatit Akademik nr. 79 datë 08. 09. 2020 "Për Kostituimin e Senatit Akademik të Universitetit " Ismail Qemali", Vlorë është i njëjtë me vendimin e Vendimin e Senatit Akademik nr. 40 datë 29.01.2020 "Për Përzgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit të Etikës në Universitetin " Ismail Qemali", Vlorë"[9]. Në Këshillin e Etikës njëri prej anëtarëve është student.
Në Standardin V.5/2, GVJ reflekton ndryshimin si vijon: Ndërsa përsa i përket përfshirjes së studentëve në vendimmarrje e këshillim rezulton se institucioni nuk disponon asnjë dokument, që të vërtetojë pjesëmarrjen e studentëve në Senatin Akademik".
*GVJ i qëndron vlerësimit fillestar të standardit: përmbushet kryesisht.*

❖ **STANDARDI VI.1**

**Kriteri 3:** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.

***GVJ ndër të tjera komenton:*** "Rezulton se institucioni nuk ka paraqitur asnjë dokument që të faktojë përdorimin e instrumenteve të duhura për sigurimin e cilësisë përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional."

**Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP argumenton:** Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me ASCAL si personi juridik publik përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, i kushton një rëndësi të veçantë vlerësimit të jashtëm të cilësisë, nëpërmjet një sërë Instrumentash dhe proçesesh:

- Gjatë muajit Qershor 2020, Institucioni ju nënshtruar proçesit të akreditimit periodik institucional, i cili përfundoi me sukses me një vlerësim pozitiv për një periudhë kohore 5- vjeçare. (Vendim i Bordit të Akreditimit nr. 50, datë 27. 11. 2020).

---

[2] Vendim Senati nr. 40, datee 29.01.2020, publikuar ne faqen zyrtare te Universitetit: https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2020/02/Vendim-Nr.-40-Dt.-29.01.2020.pdf
[3] Evidenca VI.5 Urdhër Nr. 123 datë 19.12.2019 ( Dorëzuar me Dosjen e Akreditimit)
[4] Urdhër mbi ngritjen e grupit të punës ad-hoc për pilotimin e pyetësorit të shërbimeve mbeshtetëse.
[5] Evidenca: Studentë të Angazhuar në grupin e punës mbi sondazhin kombëtar të studentëve
[6] Evidenca J- Raporti vjetor i UV-së për vitin 2018-2019, fq 118-119( Dorëzuar me Dosjen e Akreditimit)
[7] Aneks 1: Tabela 24 Të dhëna për anëtarët e NJBSC, Pjesë përbërëse e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm.
[8] Evidenca H- Rregullore për implementimin e ICM, neni 12 ( Dorëzuar me Dosjen e Akreditimit)
[9] Vendim Senati nr. 40, datee 29.01.2020, publikuar ne faqen zyrtare te Universitetit: https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2020/02/Vendim-Nr.-40-Dt.-29.01.2020.pdf

- Gjatë periudhës Prill 2019- Prill 2021 përfundoi proçesi i Akreditimit të gjithë programeve të Studimit të Ciklit të Parë UV-së. (25 programe studimi)
- Një tjetër mekanizëm i vlerësimit të jashtëm ishte pjesëmarrja aktive e UV-së në **Sondazhin Kombëtar të Studentëve (SKS) të organizuar prej ASCAL** gjatë vitit 2019. Në institucion u ngritën një grupe pune specifike per çdo Njësi Kryesore[10] të cilët ndoqën të gjithë proçesin duke filluar prej ndërgjegjësimit dhe informit të studentëve për të marrë pjesë në sondazh, asistimin nga ana teknike të proçesit etj.
- Së fundmi, që prej muajit janar studentë të UV janë duke Vlerësuar mësimdhënien online, nëpërmjet Sondazhit për "Zhvillimin e mësimit online", të organizuar prej ASCAL, i cili është përsëri një instrument i vlerësimit të jashtëm.

**Përgjigjja GVJ:**
GVJ vlerëson përpjekjet e insitucionit për pjesëmarrjen në sondazhe kombëtare si dhe në organizmin e sondazhit për "Zhvillimin e mësimit online", por insitucioni nuk paraqet vlerësimeve analitike e krahasuese.
Vlerësimit për Standardin V.5/2 Rezulton se institucioni nuk ka paraqitur asnjë dokument që të faktojë përdorimin e instrumenteve të duhura për sigurimin e cilësisë përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional."
*GVJ i qëndron vlerësimit fillestar të standardit: përmbushet kryesisht.*

- ❖ **STANDARDI VI.5**

**Kriteri 2:** Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.

***GVJ ndër të tjera komenton:*** "Rezulton se institucioni nuk ka paraqitur asnjë dokument që të faktojë publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit. ( Kriteri 2)

**Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP argumenton:** Referuar "Proçedurës së Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për Lëndët e çdo Programi Studimi në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, miratuar me Vendim Senati nr.21 , datë 08.05.2018, pas përcjelljes së Raportit të Analizës së Pyetësorëve pranë çdo Njësie Kryesore më tej çdo njësie bazë, Raporti Publikohet edhe në faqen zyrtare të Internetit të Universitetit. Në referenca gjenden linket e raporteve , të cilat janë një dëshmi e drejtpërdrejtë e publikimit të raportit.[11] Me qëllim ruajtjen e privatësisë dhe lirisë akademike rezultatet për çdo probram studimi studimi, publikohen në nivel programi studimi në trajtën e mesatares aritmetike të përgjigjeve për çdo pyetje dhe çdo lëndë.

**Përgjigjja GVJ:**
GVJ pasi shqyrtoi dokumentet e publikuara në faqen zyrtare të UV të Proçedurës së Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për Lëndët e çdo Programi Studimi në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, konstatohet se

[10] Evidence: Studentë të Angazhuar në grupin e punës mbi sondazhin kombëtar të studentëve
[11]https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/12/Fakulteti-i-Shkencave-Humane-Raporti-i-Analizes-se-Pytesoreve-te-Studenteve-.pdf dhe https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/12/Fakulteti-i-Shkencave-Humane-Raporti-i-Analizes-se-Pytesoreve-te-Studenteve-.pdf

instumentet e vlerësimit të ngritur si dhe analiza e të dhënave ka në fokus të studimit të saj performancën e lektorit dhe vlerësimin e programit të studimit.
Vlerësimi për Standardin VI.5/2 i qëndron vlerësimit: Rezulton se institucioni nuk ka paraqitur asnjë dokument që të faktojë publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit. *GVJ i qëndron vlerësimit fillestar të standardit: përmbushet kryesisht.*

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor"

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT "BACHELOR"

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. | Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës është themeluar me VKM nr.105[12] datë 28.02.1994 dhe prej vitit 1994 mban emrin Universiteti "Ismail Qemali" (UV). UV ofron disa programe studimi, në të cilat përfshihet edhe Programi i Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor". Ky program nuk bie ndesh me interesat kombëtare, është në përputhje me politikat kombëtare dhe mbështet planet strategjike të Qeverisë shqiptare[13]. |
| **Kriteri 2.** Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Qarku i Vlorës shquhet për traditat arsimore që morën zhvillim që me krijimin e Qeverisë së Vlorës në vitin 1912, si dhe të institucioneve arsimore që në atë periudhë. Departamenti i Edukimit në UV u krijua me këtë emër në vitin 2009, i cili në vijimësi ka krijuar profilin e vet të veçantë në përbërje të Universitetit. Programi synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore të sanksionuara në parimet e funksionimit të UV[14]. Ndërkohë, institucioni ofron programe studimi në fusha të ndryshme në të tri ciklet e studimit të arsimit të lartë, si dhe programe studimi me karakter profesional, referuar niveleve 5, 6, 7 dhe 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve[15]. |
| **Kriteri 3.** Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Programet e studimit që mbulohen nga Departamenti i Edukimit janë në harmoni me strategjinë e veçantë të zhvillimit të institucionit. Programi i studimit "Mësuesi për Arsimin fillor ka për qëllim zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës në shërbim të lirisë e diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për rritjen e mirëqenies e dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme e transparente.[16] |

[12]Evidenca I.1- Krijimi i UV: VKM Nr 105, datë 28.02.1994
[13] https://univlora.edu.al/programet-e-studimit-bachelor/
[14] Evidenca A- Statuti UV-se, Neni 5, fq. 8
[15] Evidenca A- Statuti i UV-së; Kreu 1, Neni 3, pika 1.a
[16] Evidenca A- Statuti i UV-së; Kreu 1, Neni 3, pika 1b, Neni 4, Pika 1

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | Bazuar në Nenin 3, Roli dhe misioni, të Statutit të UV-së, në Misionin e UV-së[17], si dhe në Misionin e Departamentit të Edukimit[18], programi i studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin fillor"[19], është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë duke kontribuar për nxitjen e njohurive dhe shkencës përmes punës kërkimore shkencore, punës akademike, aktivitetit krijues e bashkëpunimit me të tretët, si dhe zhvillimin e veprimtarisë së mësimdhënies bashkëkohore dhe kërkimit shkencor. Në këto dokumente konstatojmë se "Qëllimi dhe Misioni" i programit të studimit përputhet me qëllimet dhe misionin e institucionit. Misioni i DE-së lidhet edhe me garantimin e cilësisë dhe sigurimin e standardeve akademike për të gjitha programet e studimit. Programi i studimit mbështetet në objektiva të qarta për kualifikimin e nevojshëm të specialistëve mësues për të nxitur zhvillimin ekonomik kombëtar, rajonal dhe lokal. Përgatitja e mësuesve specialistë me një formim akademik dhe metodik bashkëkohor, ndikon direkt në mirëedukimin e brezave të rinj, si punëtorë, teknikë e specialistë të ardhshëm që do vënë dijet e tyre në shërbim të zhvillimit ekonomik të vendit, por në këtë mënyrë rritet dhe besimi tek figua dhe profesioni i "Mësuesit[20]. Sa i përket numrit të kuotave të kërkuara, gjykojmë se duhet bërë një analizë e detajuar dhe të zbatohet një strategji veprimi për të siguruar përputhje midis nevojave relae të tregut pë rmësues të arsimit fillor dhe rritjes së numrit të stuudentëve në këtë program studimi vit pas viti akademik. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br>**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | Programi i studimit është në harmoni me Planin Strategjik të zhvillimit të UV 2018 -2024[21], vizionin dhe misionin e UV-së[22]. Me vendim Nr 67, datë 31.10.2018, Nr.1334/1 prot, Vlorë, më 06.11.2018, Senati Akademik, mbështetur në nenin 38, pika 1, gërma b, Nenin 49, pika 1, gërma b të ligjit Nr. 80/2015, ka vendosur miratimin e planit strategjik të zhvillimit të Universitetit "Ismail Qemali" për periudhën 2018 – 2024. Programet e studimit ofrohen në përputhje me objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare, siç përshkruhet edhe në strategjinë dhe në statutin e UV[23]. Të gjitha programet e studimit të UV synojnë të jenë në mbështetje të strategjisë kombëtare dhe ndërkombëtare[24]. |

---

[17] Evidenca A- Statutit UV-se, Kreu I, Neni 3, pika 1b, Neni 4, pika 1.
[18] Evidenca I.3-Rregullorja e Departamentit të Edukimit, Neni 2. Misioni dhe objektivat, pika 2.1; 2.2.
[19] Evidenca I.4-Plani Mesimor i Programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"
[20] Evidenca A- Statuti i UV-së, Kreu 1, Neni 3, pika 2. b, ç, e.
[21] Evidenca B- Plani strategjik i UV 2018-2024, fq 13,14.
[22] Evidenca B- Plani strategjik i UV 2018-2024, fq 22,24.
[23] Evidenca A - Statuti i UV-së; Kreu I, Neni 3, pika 2

| | |
|---|---|
| | Vizioni dhe strategjia për zhvillim e institucionit mbështetet fuqishëm në vlerat e tij në mësimdhënie cilësore, kërkim dhe hulumtim profesional, integritet dhe dinjitet social[25]. |
| **Kriteri 2.** Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | Nga shqyrtimi i Statutit dhe Rregullores së UV-së identifikohen parimet dhe përparësitë akademike (Neni 3, Roli dhe Misioni dhe Neni 4, Qëllimet të Statutit të Universitetit) mbi të cilat se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit[26]. Këto kanë bërë që programi i studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" të jetë në përputhje me drejtimet akademike të përcaktuara në Statutin e UV[27]-së, dhe Rregulloren e UV[28], në përputhje me standardet më të mira të cilësisë së mësimdhënies, kur merren në konsideratë zhvillimet e teknologjisë së informacionit në aspektin e burimeve dhe marrjes së informacionit si dhe në përputhje me drejtimet prioritare akademike të institucionit. Në rregulloren e Departamentit të Edukimit[29] përcaktohet qartë se ky departament ofron programe të studimit me kohë të plotë, të ciklit të parë dhe të dytë. Programet e ciklit të parë janë organizuar në tre vite akademikë (6 semestra) dhe në përfundim të tyre studentët grumbullojnë 180 ECTS dhe fitojnë diplomën: Bachelor në "Histori-Gjeografi", Bachelor në "Arsimin parashkollor", Bachelor në "Mësuesi në Arsim Fillor", Bachelor në "Pedagogjinë e Specializuar Sociale". Në Statutin e UV, në nenin 2 "*Misioni dhe Vizioni*", përcaktohet se misioni kryesor i institucionit synon të përmbushë këto detyrime: rritje të standardeve të cilësisë; formim të specialistëve të rinj, përmirësime në programet e studimit me qëllim krijimin e aftësive që përputhen me kërkesat e tregut të punës, kompetenca profesionale të shumëfishta; programe gjithëpërfshirëse për aftësimin dhe zhvillimin e studentëve; kërkim shkencor cilësor.<br>Në Rregulloren e Programit[30] detajohen qëllimi i programit dhe rezultatet e pritshme pas përfundimit të programit. Del qartë se aftësimi në tre fushat e kompetencave (teorike thelbësore, praktike funksionale, si edhe komunikuese) si synimet që duhet të arrihen në përfundim të programit, janë në harmoni me misionin kryesor të institucionit, të shprehura me detaje në statutin e institucionit dhe në dokumentet e tjera rregullatore. |
| **Kriteri 3.** Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. | Organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit rezulton se është plotësisht në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të UV dhe strategjisë së zhvillimit të tij. Programi i studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" siguron Diplomë Universitare Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" në përputhje me fushat e drejtimet akademike të UV-së[31] sipas rregullores përkatëse të programit të studimit[32]. |

[24]Evidenca B - Plani Strategjik 2018-2024 I UV; fq.13
[25] Evidenca B-Plani strategjik 2018-2024 I UV; fq.22.
[26] Evidenca C-Rregullore e UV-se e ndryshuar, neni 4, 36, 37
[27] Evidenca A-Statuti i UV-se, neni 3, neni 4 pika 4.
[28] Evidenca C-Rregullore e UV-se e ndryshuar, neni 4, 36, 37.
[29] Evidence I.3- Rregullore e Departamentit të Edukimit, Kreu IV, Neni 13. Programet e studimit, Pika 13.1, 13.2, 13.3.
[30] Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor", Kreu III, neni 9
[31] Evidenca C- Rregullore e UV-se e ndryshuar, Kreu V: Organizimi i studimeve universitare, nenet 35, 36, 37.
[32] Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor", Kreu III, neni 9

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Programi Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" është organizuar dhe strukturuar në zbatim të ligjit të arsimit të lartë, si dhe udhëzimeve të MARS[33] dhe rezulton se në momentin e themelimit të programit të studimit *Mësuesi për Arsimin Fillor* ka qënë në fuqi Ligji nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, neni 22 në të cilit theksohej se arsimi fillor përbëhej nga 6 klasa. Ndërsa me hyrjen në fuqi të Ligjit 56/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 69/2012", arsimi fillor përbëhet nga 5 klasa. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi I.3**<br>**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit. | Programet lëndore [34] të ciklit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" kanë objektiva të qartë për formimin e studentëve në këtë program, duke përfshirë dijet, aftësitë, kompetencat profesionale që fitojnë studentët në përfundim të këtij programi dhe që karakterizojnë këtë profil (Sipas, VKM, dt 24/01/2018)[35]/[36] studimet në DE për programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor", synojnë formimin dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e drejtimit të mësimdhënies etj. Studimet në këtë program synojnë të sigurojnë njohuritë themelore në këto fusha nëpërmjet integrimit të mësimit me kërkimin. Kurrikulat dhe programet mësimore krijojnë mundësi të gjera që çdo student, sipas objektivave apo preferencave, të specializohet më ngushtë dhe më cilësisht në fushën e mësimdhënies.Programi i studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"[37] parashikon fitimin e tre kompetencave (teorike thelbësore, praktike funksionale, si edhe komunikuese), synimet e pritshme, por edhe mundësinë për të ndjekur programe të tjera studimi të ciklit të dytë në edukim si "Master Profesional" apo "Master Shkencor", duke iu përgjigjur nevojave të tregut të punës. Në përfundim të programit të studimit, studentët fitojnë një qasje të përgjithshme mbi mësimdhënien, metodat tradicionale dhe bashkëkohore, duke fituar shprehi dhe aftësi për |

[33] VKM Nr 41, datë 28.01.2018
[34] Evidenca I.6 - Syllabuset e lëndëve
[35] Vendimi Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë
[36] Evidenca 1.7 - Rregullore e FSHH, Neni 3, Pika 1
[37] Evidenca I.5 - Rregullore e programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"; Kreu I. Dispozita të përgjithshme; Neni 2, Fq.1

| | |
|---|---|
| | t'u përballur me objektivat dhe qëllimet strategjike të këtij profesioni. |
| **Kriteri 2.** Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. | *Nuk ka një studim të mirëfilltë të tregut të punës, i cili të përditësohet në mënyrë periodike nga Departamenti i Edukimit.* Elementë të veçantë si: komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, mundësitë e punësimit të studentëve (takime me punëdhënësit në sektorin publik dhe privat, gjatë udhëheqjeve të praktikës mësimore) si dhe të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar (statistika ALUMNI) jane pjesë e aktiviteteve të Drejtorisë së Edukimit në UV, e cila gjatë vitit 2017-2018, 2018-2019 ka gjurmuar studentët e diplomuar për të parë punësimin e tyre dhe në këtë mënyrë efektivitetin e degëve që UV-ja ofron lidhur me tregun aktual të punës. Burime të informacionit janë: - Kontakti nëpërmjet *e-mail-it, k*ërkesës zyrtare nëpër institucione të ndryshme nëpër rrethe. Rreth 68% e studentëve që përfundojnë studimet në Fakultetin e Shkencave Humane (FSHH), punojnë në profesionin e tyre. Kryesojnë degët e Ciklit të Ulët dhe Parashkollorit me 98% të punësuar (2018-2019).<br>Gjatë vitit 2017-2018[38] dhe në zbatim të Rekomandimit Nr.4 të vendimit Nr.71, datë 21.09.2017 të Bordit të Akreditimit, është bërë gjurmimi i studentëve të diplomuar në UV për të pare punësimin e tyre dhe në këtë mënyrë efektivitetin e degëve që UV ofron lidhur me tregun aktual të punës. Rreth 92% e studentëve që përfundojnë studimet në FSHH punojnë në profesionin e tyre. Nga ky raport jepen të dhëna që numri i studentëve të diplomuar të gjurmuar në (Arsim Parashkollor) është 6, punojnë në profesionin e tyre 3, në % mesatare 50%. Ndërsa në vitin 2018-2019[39], nga ana e Drejtorisë së Edukimit, është bërë e mundur marrja e të dhënave për punësimin e tyre, numri i studentëve të diplomuar të gjurmuar në (Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor", dhe Parashkollor) është 671, punojnë në profesionin e tyre 655, pra rreth 98.% e ish studentëvve të gjurmuar. |
| **Kriteri 3.** Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. | Nga shqyrtimi i Programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"[40] rezulton se ai ka objektiva formuese, një strukturë të organizuar si dhe një përmbajtje që garanton përfitimin e shkathtësive, aftësive dhe kompetencave, rezultate këto të pritshme të të nxënit, për t'iu përgjigjur nevojave të tregut të punës dhe lehtësimin e punësimit të studentëve përcaktuar në Planin Strategjik të Departamentit[41]. Studentët me Diplomë bachelor marrin një përgatitje të nivelit universitar, e cila i bën të aftë të punojnë dhe të zhvillojnë aktivitetin e tyre si |

[38] Evidenca I - Raporti vjetor i UV për vitin 2017-2018; fq.96.
[39] Evidenca J – Raporti vjetor I UV për vitin 2018-2019; fq.117-118.
[40] Evidenca B - Plani Strategjik 2018-2024; Pika 2.4 Kurrikula, fq. 12-14.
[41] Evidenca I.8 - Strategjia e Departamentit të Edukimit; Misioni i Departamentit, fq. 2.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | edukatorë, mësimdhënës dhe drejtues të institucioneve arsimore. Kryerja e këtij cikli studimesh i pajis studentët me një spektër të gjerë njohurish dhe formim universitar për mësimdhënien në nivele të ndryshme grupmoshash, duke integruar aftësitë e studentëve me njohuritë që do të fitojnë gjatë kryerjes së studimeve në degët e "Mësuesisë me praktikën "e gjallë" në shkolla. Programi i studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" është i organizuar në pesë veprimtari formuese[42], kurse qëllimet e synimet (rezultatet e pritshme) do të arrihen përmes zhvillimit të lëndëve të natyrave të ndryshme, të tilla si: lëndë bazë të formimit të përgjithshëm dhe metodologjik, lëndë me formim specifik, lëndë të natyrës ndërdisiplinore dhe integruese, lëndë të natyrës plotësuese si gjuhë e huaj, si edhe detyrime përmbyllëse. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi I.4**<br>**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar. | Programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor" zbatohet nga një staf kryesor akademik dhe staf ndihmës, i cili është një kombinim brezash, kulturash, si edhe përvojash të shumëllojta[43]. Në staf[44] ka pedagogë me përvojë të gjatë në fushën e mësimdhënies, si edhe staf më të ri që kanë përfunduar me sukses studimet pasuniversitare jashtë shtetit. Gjithashtu, stafi akademik ka në jetëshkrimin e tij specializime të shumta dhe të shumëllojshme si edhe mbart mbi vehte një përvojë të pasur shumëvjeçare. Si rrjedhojë, burimet njerëzore dhe infrastrukturore janë të mjaftueshme[45] për zhvillimin në normalitet të procesit mësimor si edhe ka një qëndrueshmëri të kuadrit akademik, si edhe një raport të përshtatshëm midis brezave të ndryshëm të personelit akademik. |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në | Departamenti i Edukimit është hartuesi dhe zbatuesi i Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin |

[42] Evidenca I.4 - Plani Mesimor i Programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9).

[43] Aneks 1 - Tabela 1. Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë (Fakulteti i Shkencave Humane)

[44] Aneks 1 - Tabela 4. Ngarkesa totale e personelit akademik të programit "Mësuesi për Arsimin Fillor" për vitin akademik 2019

[45] Aneks 1 - Tabela 4. Ngarkesa totale e personelit akademik të programit "Mësuesi për Arsimin Fillor" për vitin akademik 2019

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Fillor" duke u mbështetur në Ligjin nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", duke patur si referencë gjithashtu nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Udhëzimin nr.1 datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si edhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë, i ndryshuar", VKM-në nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", si edhe duke respektuar liritë dhe detyrimet akademike të personelit akademik dhe të studentëve. | | | |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Rregullorja e Programit të Studimit[46] përcakton mënyrat e ndarjes së ngarkesës mësimore, disiplinat formuese, infrastrukturën mësimore si edhe personelin akademik përgjegjës. Gjithashtu, në rregullore përcaktohen me saktësi mënyra e vlerësimit dhe e diplomimit të studentit, si edhe syllabuset e lëndëve. Sistemi i krediteve është i njëjtë me sistemin europian ECTS. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi I.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda | Departamenti i Edukimit bashkëpunon me njësitë e tjera të UV për realizimin e mësimdhënies në lëndët/modulet që i përkasin formimit të përgjithshëm apo formimit të natyrës informatike apo teknologjike[47]/[48]. |

[46] Evidenca I.5-Rregullore e programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor";
[47] Evidenca A-Statuti i UV-së, Neni 6 pika 5
[48] Evidenca I.7-Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Kreu 1: Parime të Përgjithshme, Neni 3, Qëllimet bazë, Pika 1; Neni 15, Neni 16, Neni 17

| | |
|---|---|
| institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | UV ka një strategji të ndërkombëtarizimit[49], si dhe zbaton një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me universitete të huaja si: Universiteti i Leçes, Barit, Mesinës, Perugias, Kozencës (Itali), Liezhit (Belgjikë), Kretës (Greqi), Universiteti i Talin-it (Estoni), Universiteti i Turku-t (Finlandë) Universiteti i Vigo-s, Valencia -s (Spanjë), Universiteti i Nish-it (Serbi), Universiteti i Shkencave Natyrore Sofje (Bullgari), Universiteti i Timisoharës (Rumani), Universiteti i Alesundit (Norvegji) etj[50] në të cilat dhe pedgaogët e Deparatemnti të Edukimit kanë shkëmbyer përvoja profesionale. Departamenti i Edukimit ka nënshkruar marrëveshje dhe me Drejtorinë Rajonale Arsimore Vlorë[51]. |
| **Kriteri 3.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve. | Lidhur me programin e studimit, Departamenti i Edukimit harton raporte analitike për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, por dhe lidhur me ndikimin pozitiv që kanë patur aktivitetet e zhvilluara në kuadër të këtyre marrëveshjeve, të cilta pasqyrohen në raportin e analizës vjetore të UV[52] dhe të departamentit. |
| **Kriteri 4.** Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë. | Departamenti i Edukimit ka nënshkruar marrëveshje me institucionet të ndryshme për mbikqyrjen e praktikave profesionale të studentëve në varësi të natyrës specifike të tyre[53]. Personeli akademik në përbërje të Departamentit të Edukimit mbulon pozicione të ndryshme në komisionet e ngritura për tematikë të ndryshme apo për ndjekjen e praktikës së studentëve. |
| **Kriteri 5.** Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | Në nivel institucioni qëndror funksionon ofrohen trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me institucionet duke vendosur në dispozicion zyrën e Life Long Learnig (LLL). Departamenti i Edukimit në kuadër të riformatimit të strategjisë së promovimit[54] është në proces studimi të tregut dhe për ofrimin e programeve të studimit të formimit të |

[49] Evidenca D-Strategjia e Ndërkombëtarizimit
[50] Lista e plote e marreveshjeve nder institucionale: https://univlora.edu.al/sektori-projekteve/marreveshje-nderinstitucionale/
[51] Aneks 1-Tabela 5. Institucionet bashkëpunuese për Praktikat Profesionale
[52] Evidenca J- Raporti vjetor i UV per vitin 2018-2019, fq 20 -23(Bashkëpunimet Ndër-institucionale)
[53] Aneks 1-Tabela 5. Institucionet bashkëpunuese për Praktikat Profesiona
[54] Evidenca I.8 - Strategjia e Departamentit të Edukimit; Misioni i Departamentit

| | |
|---|---|
| | vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR"

| **Standardi II.1**<br>**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Prej krijimit në vitin 1998-1999 programi ka qënë quajtur "Cikël i Ulët" me afat 4 (katër) vjeçar dhe përgatiste mësues të arsimit fillor.[55]<br>Në vitin 2005, bazuar në Sistemin e Bolonjës për arsimin e lartë, programi u ristrukturua në "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor"[56].<br>Sot programi zhvillohet në 6 semestra me 15 javë mësimore secili[57] dhe është i organizuar në lëndë/module që mbulojnë 30 ECTS për çdo semestër. Lëndët/modulet organizohen në leksione dhe/ose seminare.<br>Kurrikula[58] e këtij programi për vitet 2017-2020 ndahet sipas kategorive të mëposhtme:<br>A. Lëndë bazë (32 kredite – 18%);<br>B. Lëndë karakterizuese (96 kredite – 54%);<br>C. Lëndë Ndërdsiplinore/Integruese (24 kredite – 13%);<br>D. Lëndë Plotësuese (22 kredite – 12%);<br>E. Detyrime Përmbyllëse (6 kredite – 3%); |
| **Kriteri 2.** Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e | Programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor", bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit[59], synon midis të tjerash që: të pajisë studentët me njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit me aftësi drejt fitimit të një profesioni; të formojë profesionistë me aftësi bazë për punë kërkimore dhe me |

[55] Vendim i MASH Nr.143, datë 04.08.1998
[56] Evidenca A-Statuti i UV-së, Neni 70, pika 1
[57] Evidenca I.5. Rregullore e programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në mësuesi për arsimin Fillor", Kreu III, neni 9
[58] Aneks 1. Tabela 9 - Plani mesimor, i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)
[59] Evidenca I.5-Rregullore e programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor";

| | |
|---|---|
| specialitetesh. | aftësi praktike, zbatuese, si edhe promovuese; të aftësojë studentët për zgjidhjen e situatave problemore; të aftësojë studentët për të zbatuar teorinë duke u mbështetur në përvojën dhe praktikat e suksesshme në arsim, etj. |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. | Në Rregulloren e Programit të Studimit[60] "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor" theksohet se në përfundim të programit, nga studentët synohet që: të marrin njohuri teorike për shkencat shoqërore, natyrore dhe artet e aplikuara; të pajisen me njohuritë e përshtatshme teorike dhe kompetencat e duhura për arritjen e standarteve të larta në mësimdhënies në arsimin fillor; të formojnë kompetenca shkencore, psikopedagogjike, gjuhësore, sistemike, dhe të teknologjisë së informacionit. |
| **Kriteri 4.** Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor", nisur nga Rregullorja e Programit të Studimit[61], synon që t'u mundësojnë studentëve njohuritë e nevojshme për fitimin prej tyre të:<br>- Kompetencave teorike-thelbësore<br>- Kompetencave praktike funksionale<br>- Kompetencave komunikuese<br>Gjithashtu, në përfundim të programit, synohet që studenti: të aftësohet për zgjidhjen e situatave problemore, për menaxhimin e mjedisit njohës, social, emocional, si edhe fizik të klasës; të formohet si qytetar me aftësi bazë për punë kërkimore, me aftësi të përgjithshme praktike, zbatuese, si edhe promovuese. |
| **Kriteri 5.** Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. | Rregullorja e Programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor" është rishikuar dhe përshtatur për çdo vit akademik, duke pasqyruar ndryshimet dhe kërkesat ligjore të rrjedhura nga zbatimi i Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si edhe i Ligjit nr.10171 datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë". Gjithashtu, programi i studimit përfshin të gjitha elementet që parashikon si të detyrueshme VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". Kështu, programi i studimit për vitin 2019-2020:<br>– Siguron ndarje të lëndëve mësimore në lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë plotësuese, si edhe detyrime përmbyllëse, duke përcaktuar me detaje fushat disiplinore si edhe kreditet përkatëse për çdo lëndë.<br>– Programet specifike të çdo lënde janë bazuar dhe plotësojnë kërkesat e Shtojcës nr.2 të VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit kanë të përcaktuar | Rregullorja e Programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor" për vitin 2019-2020 përmban informacion të |

[60] Evidenca I.5-Rregullore e programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor";
[61] Evidenca I.5-Rregullore e programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor";

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | detajuar lidhur me veprimtarinë formuese duke i ndarë lëndë/module sipas kategorive të përcaktuara së bashku me ngarkesën përkatëse në kredite. Rezultatet dhe kompetencat e të nxënit jepen me hollësi në secilin prej syllabuseve (programeve lëndore) të hartuara nga titullari i lëndës dhe të miratuara nga Përgjegjësi i Departamentit. Programet lëndore i bashkëngjiten Rregullores së Programit dhe konsiderohen dokumenti bazë i aktivitetit lëndor.[62] | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. | Referuar Vendimit të MASR nr.418, datë 10.5.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre", kërkesë kryesore për hapjen e një programi studimi është që ***"Njësia bazë duhet të ketë në përbërje të tij, të paktën, 7 anëtarë me kohë të plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të jenë me gradë shkencore ose titull akademik'*****, Departamenti i Edukimit në UV për vitin akademik 2019-2020 ka në përbërje të tij 19 pedagogë me kohë të plotë dhe 7 me kohë të pjesshme**. Gjithashtu, Departamenti i Edukimit plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në Vendimin e MASR nr.418, datë 10.5.2017 lidhur me standartet e organizimit, standartet për personelin akademik, si edhe standartet dhe normativat infrastrukturore[63]/[64]/[65]/[66]. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e | Departamenti i Edukimit në përmbushje të detyrimeve ligjore sipas ligjit Nr 80/2015, Grupi mësimor i Edukimit[67]/[68]/[69], ka një person përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave, i cili është në kontakt të vazhdueshëm me Drejtuesin e Departamentit të Edukimit[70]. Janë emëruar koordinatorët e |

[62] Aneks 1. Tabela 14 - Evidenca II.2 Modeli i syllabuseve, elementët sipas VKM 41/2018

[63] Aneks 1 - Tabela 1. Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë (Fakulteti i Shkencave Humane)
[64] Evidenca II.1 - Vendim për ngritjen e grupeve mësimore në Departamentin e Edukimit
[65] Evidenca II.2 - Vendim për emërimin e Përgjegjësave të grupeve mësimore në Departamentin e Edukimit
[66] Evidenca II.3 - Emërimi i Koordinatorit për marrëdhëniet me studentët
[67] Vendim senati Nr 79 datë 12.12.2016 https://univlora.edu.al/ëp-content/uploads/2017/12/Vendim-senati-Nr.79-dt-12.12.2016.pdf
[68] Evidenca II.1 - Vendim për ngritjen e grupeve mësimore në Departamentin e Edukimit
[69] Evidenca II.2 - Vendim për emërimin e Përgjegjësave të grupeve mësimore në Departamentin e Edukimit
[70] Evidenca A-Statuti i UV-së, Neni 77

| | |
|---|---|
| koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse. | marrëdhënieve me studentët[71] të cilët janë përgjegjës për koordinimin e marrëdhënieve të departamentit me studentët dhe kryejnë funksionin e koordinatorit të programit mësimor. Koordinatori i programit mësimor përgjigjet për organizimin, ecurinë dhe zhvillimin e programit. |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Departamenti i Edukimit në UV për vitin akademik 2019-2020 ka në përbërje të tij 19 pedagogë me kohë të plotë dhe 7 me kohë të pjesshme, nga të cilët 13 me grada dhe tituj shkencorë (12-Dr dhe 1-Prof. i asociuar.Gjithashtu, Departamenti i Edukimit plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në Vendimin e MASR nr.418, datë 10.5.2017 lidhur me standartet e organizimit, standartet për personelin akademik, si edhe standartet dhe normativat infrastrukturore[72]/[73]/[74]/[75].Në Statuin e UV[76] përcaktohen mënyra e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e Përgjegjësit të Departamentit sa i përket organizimit të planit mësimor, menaxhimin e materialit mësimor dhe të infrastrukturës në mbështetje të tij, informimin e studentëve dhe koordinimin me njësitë e tjera në FSHH.. |
| **Kriteri 4.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. | Për programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" janë të angazhuar **për vitin akademik 2019 -2020**, 19 Personel akademik efektiv PAE me kohë të plotë të ndarë si më poshtë:<br>– 1 me titull Profesor i Asociuar<br>– 12 mban gradën Dr/PhD<br>– 6 janë Master i Shkencave, ku një është në proces doktorature[77]Ndërsa personel akademik me kontratë PAK, janë gjithsej 6 me gradën MSc.<br>Raporti që del nga të dhënat e dokumentacionit për PAE/PAK për vitin akademik 2019 -2020, për programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor", thekson **mbulimin në masën 92.8% me personel akademik efektiv dhe 7.2% me personel akademik me kontratë.**<br><br>**Edhe për vitin akademik 2018 -2019**, është angazhuar i njëjti personal 19 veta PAE dhe 6 PAK me kualifikime përkatëse si në vitin akademik 2019-2020, ku ritheksjojmë mbulimin **në masën 92.8% me personel akademik efektiv dhe 7.2% me personel** |

---

[71] Evidenca II.3 - Emërimi i Koordinatorit për marrëdhëniet me studentët
[72] Aneks 1 - Tabela 1. Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë (Fakulteti i Shkencave Humane)
[73] Evidenca II.1 - Vendim për ngritjen e grupeve mësimore në Departamentin e Edukimit
[74] Evidenca II.2 - Vendim për emërimin e Përgjegjësave të grupeve mësimore në Departamentin e Edukimit
[75] Evidenca II.3 - Emërimi i Koordinatorit për marrëdhëniet me studentët
[76] Evidenca A- Statuti UV-së, Neni 6, pika 5
[77] Aneks 1 - Tabela 1. Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë (Fakulteti i Shkencave Humane)

| | |
|---|---|
| | **akademik me kontratë.** |
| **Kriteri 5.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Departamenti i Edukimit në FSHH ka në përbërjen e tij 19 personel akademik me kohë të plotë, duke patur 13 anëtarë me tituj dhe grada shkencore. Në Rregulloren e UV[78] përcaktohen mënyra e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e Përgjegjësit të Departamentit sa i përket organizimit të planit mësimor, menaxhimin e materialit mësimor dhe të infrastrukturës në mbështetje të tij, informimin e studentëve dhe koordinimin me njësitë e tjera në FEF[79]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.3**<br>**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuara dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | Rregullorja e Programit të Studimit[80] tregon:<br>- në pikën 7 strukturat akademike përgjegjëse dhe strukturat e tjera bashkëpunuese,<br>- në pikën 8 përshkruan programin e studimit,<br>- në pikën 9 jep strukturën e planit mësimor,<br>- në pikën 13/14paraqet lëndët dhe modulet e programit të studimit.<br>Më tej në këtë rregullore jepen detyrimet e mundshme që lidhen me frekuentimin, format e studimit dhe të vlerësimit, infrastruktura në dispozicion të programit, si edhe lista e syllabuseve të lëndës. Departamenti i Edukimit[81] ka diskutuar edhe ndryshimet e mundshme në Rregulloren e Programit të studimit, duke synuar përditësimin e saj në përputhje me zhvillimet e reja, si edhe duke u bazuar në pritshmëritë e regjistrimeve dhe sugjerimet që mund të vijnë nga faktorë të ndryshëm. |
| **Kriteri 2.** Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. | Plani Mësimor i Programit të Studimit[82] është ndërtuar në përputhje me përcaktimet e VKM nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"[83] dhe përcakton lëndët/modulet e ndara në vite akademike dhe semestra. Për çdo lëndë/modul |

[78] Evidenca A- Statuti UV-së
[79] Aneks 1. Tabela 6 (6.1; 6.2; 6.3 dhe 6.4).
[80] Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor": Neni 3, Kreu III, Nenet 7,8,9,13,14
[81] Evidenca I.3 - Rregullorja e Departamentit të Edukimit
[82] Aneks 1. Tabela 9. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)
[83] VKM Nr.41, datë 24.01.2018, *"Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL"*

| | |
|---|---|
| | përcaktohen viti/semestri kur zhvillohet, orët në auditor, orët jashtë auditorit, detyrimet e shlyerjes, si edhe kreditet. |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. | Plani Mësimor i Programit të Studimit[84] parashikon për çdo lëndë/modul vitin/semestrin kur zhvillohet si edhe kreditet që i përkasin çdo lënde. Kështu:<br>- A. Lëndë bazë: përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (32 kredite – 18%). (Sipas udhëzimit duhet të përmbajë 15-20% të krediteve).<br>– B. Lëndë të formimit karakterizues: përgatitje për disiplinën shkencore: (96 kredite – 54%). (Sipas udhëzimit duhet te permbajë 50-55% të krediteve);<br>- C. Lëndë Ndërdsiplinore/Integruese: Lëndë të formimit të ngjashëm ose/dhe integruese me lëndët karakterizuese si dhe lëndë formuese të zgjedhura nga studentët: (24 kredite 13%). (Sipas udhëzimit duhet të përmbajë 12-15% të krediteve);<br>- D. Lëndë Plotësuese: Lëndë formuese dhe aktivitete që lidhen me përftimin e aftësive për të lehtësuar hyrjen në tregun e punës si: për njohje të gjuhës së huaj, informatikës, praktikë: (22 kredite –12%). (Sipas udhëzimit duhet të përmbajë 10-15% të krediteve);<br>- E. Detyrime Përmbyllëse: Teza e diplomës, ose provimi i formimit: (6 kredite 3 %). (Sipas udhëzimit duhet të përmbajë 3 -5 % të krediteve).<br>Gjithsej kredite ECTS janë 180. |
| **Kriteri 4.** Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. | Programi i Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor" përmban edhe Planin Mësimor[85] të Programit të Studimit, i cili është hartuar nga titullari i lëndës/modulit dhe sipas përcaktimeve dhe objektivave të programit të studimit. Plani mësimor përmban përshkrimin e programit të studimit, strukturën, emrin e lëndës, ngarkesën mësimore, përmbledhjen dhe rezultatin e të nxënit, konceptet dhe temat e lëndës. Plani mësimor përcakton edhe numrin e lejueshëm të krediteve për çdo lëndë. Plani mësimor për Programin e Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor" gjendet edhe në Faqen Zyrtare të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë |
| **Kriteri 5.** Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e | Programi i studimit përmban të gjithë informacionin e domosdoshëmpër studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit / ripranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve[86]/[87]. Pranimi i |

[84] Aneks 1. Tabela 9. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)

[85] Tabela 9. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)
[86] Evidenca I.5- Rregullore e programit Bachelor në mësuesi për Arsimin Fillor, Kreu II, Neni 5, 6, 8
[87] Evidenca C - Rregullore e UV-së, Kreu V, neni 39, 44; Kreu VI, Neni 56, 58

<table>
<tr><td>përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</td><td colspan="4">studentëve në programin e ciklit të parë në “Mësuesi për Arsimin Fillor” është kryer në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 74, të ligjit nr. 80/2015, Udhëzim i MASR, Nr.10, datë 15.05.2019, Udhëzim i MASR Nr.19, datë 10.09.2019, për vitin akademik 2019–2020.<br>Çdo vit akademik, Njësitë Bazë përcjellin për miratim propozimet mbi kriteret[88] dhe kuotat[89] e pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimit, kuotat[90] dhe kriteret e transferimit të studentëve në UV, në funksion të kapaciteteve pritëse dhe akademike[91], në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë, Rregullores së UV-së, Statutit të UV, dhe Udhëzimeve të MASR.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</td><td colspan="4">Në Rregulloren e Programit të Studimit[92] tregohen me hollësi çdo element i programit të studimit si objektivat formuese, rezultatet e pritshme, lëndët/modulet që do të trajtohen, si edhe të gjitha programet lëndore (syllabuset) që do të trajtohen në program. Programet lëndore përmbajnë të gjitha elementët e kërkuar nga VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe tregojnë emrin e plotë të lëndës, ngarkesën, tipologjinë, vitin akademik, llojin e lëndës, temat themelore, format e kontrollit të dijeve, frekuentimin, si edhe literarturën bazë dhe atë të rekomanduar.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</td><td colspan="4">Rezulton se Departamenti i Edukimit ka Rregulloren e Programit të Studimit, e cila është funksionale për zbatimin e programit.Nga viti akademik 2016-2020 nuk ka ndryshime në programin mësimor Bachelor në “Mësuesi në Arsimin Fillor”. Departamenti i Edukimit në mënyrë të vazhdueshme përmirëson programet duke rifreskuar programet lëndore me literaturë dhe botimet bashkëkohore[93].</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

[88] Evidenca II.5- Kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit të ciklit të parë në Departamentit e Edukimit dhe procedura e pranimit të studentëve të ciklit të parë Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”

[89] Evidenca II.6 - Kuotat e pranimit të studentëve në programin e ciklit të parë Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”

[90] Evidenca II.6- Kuotat e pranimit të studentëve në programin e ciklit të parë Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”

[91] Evidenca II.7- Kapacitetet akademike dhe fizike të FSHH-së

[92] Rregullore e programit Bachelor në mësuesi për Arsimin Fillor

[93] Evidenca II.8 Literatura e miratuar në Departamentin e Edukimit.

| **Standardi II.4**<br>**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. | Programi i studimit është organizuar sipas përcaktimeve të VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". Kurrikula është shpërndarë për 3 vite akademike[94] me nga 60 ECTS secili dhe për secilin vit akademik janë përcaktuar jo më pak se 1.500 orë[95]. Është llogaritur që studentët të zhvillojnë deri 25 orë në javë në auditor[96]. |
| **Kriteri 2.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve. | Edhe shpërndarja e orëve mësimore është realizuar sipas përcaktimeve të VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". Raporti i orëve leksion/seminare, bazohet në natyrën e lëndës (nëse lëndët janë me natyre teorike apo praktike)[97]. Sa i përket zhvillimit të lëndëve me zgjedhje, ato koordinohen në varësi të numrit të studentëve që i ndjekin. |
| **Kriteri 3.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. | Shpërndarja e krediteve bazohet në kërkesat e VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" dhe është në harmoni me kërkesat e Shtojcës 1 të kësaj VKM-je. Kështu, Programi i Studimit[98] përcakton<br>- A. Lëndë bazë: përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (32 kredite – 18%). (Sipas udhëzimit duhet të përmbajë 15-20% të krediteve).- B. Lëndë të formimit karakterizues: përgatitje për disiplinën shkencore: (96 kredite – 54%). (Sipas udhëzimit duhet te permbajë 50-55% të krediteve); - C. Lëndë Ndërdsiplinore/Integruese: Lëndë të formimit të ngjashëm ose/dhe integruese me lëndët karakterizuese si dhe lëndë formuese të zgjedhura nga studentët: (24 kredite 13%). (Sipas udhëzimit duhet të përmbajë 12-15% të krediteve); Shpërndarja e kësaj ngarkese sipas planit mësimor, e ndarë në vite, semestra, apo javë mësimore |

[94] Evidenca II.9 - Kalendari akademik i Universitetit 2019-2020 https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/10/kalendari-UV-2018-2019.pdf

[95] Tabela 9. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)

[96] Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018 "Per elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të larte", pika 2.1, shkronja "d"

[97] Tabela 9. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)

[98] Tabela 9. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)

| | |
|---|---|
| | garanton arritjen e objektivave formuese të programit të studimit[99]. |
| **Kriteri 4.** Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit "Bachelor" dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | Struktura e planit mësimor[100] parashikon që gjatë vitit të parë të studimit pjesën më të madhe e zënë lëndët me karakter të përgjithshëm dhe më pak ato me formim karakterizues dhe ndërdisiplinore. Në vitin e dytë dhe të tretë raporti përmbyset në favor të lëndëve karakterizuese. Kjo shpërndarje mundëson që njohuritë që përfitohen të zgjerohen në mënyrë graduale dhe të kombinohen me kategoritë e tjera.<br>Në RVB nuk ka referenca për përafrim të programit me programe të ngjashme ndërkombëtare. |
| **Kriteri 5.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Mënyra e shpërndarjes së lëndëve në kurrikul synon lehtësimin e arritjeve të objektive formues të programit të studimit. Sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, ky program studimi është i organizuar në lëndë, module, praktika e aktivitete formuese, duke bërë të mundur arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, të dhëna që janë të detajuara në kurrikulën dhe rregulloren e programit të studimit.[101] |
| **Kriteri 6.** Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. | Rezulton se Rregullorja e Programit të Studimit[102] është përmirësuar vazhdimisht dhe është miratuar si rregullore e veçantë për tre vitet akademike 2017-2018, 2018-2019, si edhe 2019-2020. Në rregullore, si edhe në programet e lëndëve, janë pasqyruar dhe trajtuar problematikat që mund të kenë dalë në vite apo edhe përmirësimet e kërkuara nga ligji apo praktika dhe përvoja e fituar. |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë. | Programi i Studimit "Bachelor" në "Mësuesi në Arsimin Fillor" në Rregulloren e Programit[103] tregon objektivat formuese të programit, si edhe rezultatet (synimet) e pritshme të këtij programi. |
| **Kriteri 8.** Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Programi i Studimit "Bachelor" në "Mësuesi në Arsimin Fillor" në Rregulloren e Programit[104] tregon se përfundimi i këtij programi mundëson hapin e parë drejt profesionit të mësuesisë në arsimin fillor, si edhe jep mundësinë për programe studimi të ciklit të dytë në fushën e edukimit, duke iu përgjigjur tregut të punës. |

[99] Evidenca II.4- Model Diplome dhe Suplementi Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"
[100] Tabela 9. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)
[101] Evidenca II.4- Model Diplome dhe Suplementi Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"
[102] Evidenca I.5- Rregullore e programit Bachelor në mësuesi për Arsimin Fillor
[103] Evidenca I.5- Rregullore e programit Bachelor në mësuesi për Arsimin Fillor

[104] Evidenca I.5- Rregullore e programit Bachelor në mësuesi për Arsimin Fillor

| | |
|---|---|
| **Kriteri 9.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | Nga dokumentacioni i depozituar nga UV, rezulton se rregullorja e Programit të Studimit është përmirësuar duke marrë në konsideratë dhe gjetje nga aktivitete, të tilla si: "Workshopi me studentët për tregun e punës"[105] në bashkëpunim ne NJSBCVL. Në rregullore[106], si edhe në programet e lëndëve, janë pasqyruar dhe trajtuar problematikat që mund të kenë dalë në vite apo edhe përmirësimet e kërkuara nga ligji apo praktika dhe përvoja e fituar. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.5**<br>**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. | Departamenti i Edukimit mbulon Programin e studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor" dhe në të janë angazhuar 19 pedagogë me kohë të plotë, si dhe 6 pedagogë të tjerë me kohë të pjesshme. Shpërndarja e gradave dhe e titujve akademikë është e mjaftueshme për përmbylljen me sukses të programit[107] dhe është në harmoni me kërkesat e Vendimit të MASR nr.418, datë 10.5.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre", sa i përket numrit minimal të personelit akademik të kërkuar si edhe gradave apo titujve akademikë të kërkuar.<br>Dokumentacioni i plotë i stafit akademik[108] përditësohet në mënyrë të vazhdueshme nga drejtoria përkatëse e burimeve njerëzore. |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur | Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik[109]. Kështu, Departamenti i Edukimit në FSHH në përbërje të tij 19 pedagogë me kohë të plotë të ndarë si më poshtë: |

[105] Aneks 1. Tabela 1 dhe 7.

[106] Evidenca II.10 - Plani Strategjik i 2014-2024 i FSHH" i programit të studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"

[107] Evidenca II.11-CV e stafit akademik dhe ndihmës për programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"

[108] Evidenca II.11-CV e stafit akademik dhe ndihmës për programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"

[109] Evidenca II.11-CV e stafit akademik dhe ndihmës për programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"

| | |
|---|---|
| të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. | – 1 me titull Profesor i Asociuar<br>– 12 mban gradën PhD<br>– 6 janë Master i Shkencave (një nga të cilët në proces doktorature)<br>Del qartë se 13 anëtarë (më shumë se 7) prej pjesëtarëve të personelit akademik kanë grada apo tituj shkencorë. Ky numër është dukshëm më i lartë se kërkesat e Vendimit të MASR nr.418, datë 10.5.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre". |
| **Kriteri 3.** Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. | Personeli akademik me kohë të plotë ka nivel arsimimi dhe kualifikimi të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm për nivelin e këtij programi. Nisur nga jetëshkrimet e personelit akademik, rezulton se formimi i tyre bazë universitar, arsimimi i mëtejshëm plotësues, kualifikimet e mëtejshme të tyre, si edhe trajnimet e vazhdueshme të tyre, janë në përputhje me nivelin e programit të studimit. Në veçanti, rezulton, gjithashtu, se çdo pedagog mbulon ato lëndë/module që janë në përputhje me kualifikimin personal[110]. Në fillim të çdo viti akademik[111], bëhet parashikimi i ngarkesës vjetore në auditor dhe asaj jashtë auditorit dhe më pas raportohet koha vjetore të punës[112] Stafi akademik përditëson dosjen e pedagogut[113] pranë drejtorisë përkatëse duke pasqyruar në CV e pedagogut çdo kualifikim apo ndryshim tjetër me rëndësi lidhur me formimin akademik. |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Nga dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni, si edhe nga bisedat me stafin akademik, u konstatua se zhvillimi i praktikave mësimore zhvillohej konform planit mësimor. Gjithashtu, Departamenti i Edukimit në FSHH ka marrëveshje bashkëpunimi me DAR Vlorën (që është organi përgjegjës për arsimin parauniversitar për bashkinë e Vlorës), por dhe me Zyrat Arsimore Ballsh, Kuçovë, Tiranë, Durrës, Lushnjë, Fier, Berat, Skrapar, Sarandë dhe Mallakastër.<br>Sipas nenit 64, të Rregullores së UV-së, studentët kanë të detyrueshëm kryerjen e praktikës profesionale, kur ajo përfshihet në programin e studimit. Në programi e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" është e planifikuar praktika profesionale e studentëve në semestrin e 6 (gjashtë)[114]. Praktika profesionale është planifikuar 6 (javë). Departamenti i Edukimit, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm për |

[110] Evidenca II.11-CV e stafit akademik dhe ndihmës për programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"
[111] Organigrama e FSHH. https://univlora.edu.al/organigrama-fe/
[112] Evidenca II.7- Kapacitetet akademike dhe fizike të FSHH-së
[113] INSTITUCIONI, FEF, DE, "Shtojca 1.14, Udhëzim për përmbajtjen e dosjes së stafit", ASCAL, Dok. nr.18. Parë në Dhjetor 2020, gjendet në: https://ascal.al/sq

[114] Evidenca I.4-Plani Mësimor i Programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor".

<table>
<tr><td></td><td colspan="4">instruktimin, udhëheqjen e punimit të diplomës dhe veprimtari të tjera specifike, sipas natyrës së programit të studimit.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</td><td colspan="4">Në Planin Mësimor të Programit parashikohen që për formimin shkencor të studentëve të zhvillohen lëndë të tilla si Njohuri në Shkencat e Natyrës, si: Biologji, Kimi, Fizikë, TIK, por dhe Njohuri në Shkencat e Mjedisit, si: Gjeografi, por dhe Histori, si dhe module me zgjedhje në shkencat e e edukimit. FSHH vë në dispozicion personel ndihmës mësimor shkencor i cili punon në funksion të programit të studimit për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e bazës materiale[115]. Personeli ndihmës mësimor-shkencor përfshin personat përgjegjës të laboratorit, të cilët asistojnë në orët e laboratorit për modulet të cilat parashikojnë orë laboratorike, brenda strukturës së Fakultetit[116], duke mbikqyrur procesin e mësimdhënies ashtu edhe gjatë punës së pavarur të studentëve.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

[115] Organigrama e FSHH. https://univlora.edu.al/organigrama-fe/
[116] Evidenca II.7- Kapacitetet akademike dhe fizike të FSHH-së

# III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve. | UV ka një udhëzues në nivel institucional[117] për metodat innovative të mësimdhënies, ndërsa te Plani Strategjik[118] 2018-2024 të UV, në një nga skenarët e zhvillimit në planin afatmesëm dhe afatgjatë, është dhe skenari i zhvillimit "SMART", i cili fokusohet në shfrytëzimin me efektivitet të teknologjisë së komunikimit për të përsosur sistemin UVMS, procesin e mësimdhënies dhe të kontrollit nëpërmjet aplikimit të metodave inovative të mësimdhënies. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. | Organi përgjegjës për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel universiteti është Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional[119], e cila përgatit raporte të vijeushme lidhur me matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikat më të mira.Gjithashtu, në mënyrë më specifike, funksionon edhe Drejtoira e Edukimit, e cila shërben si mekanizëm periodik për çështjeve te licensimit, ngarkesave mësimore të pedagogëve, por dhe aspekte të monitorimit dhe vlerësimit të akteve ligjore për personelin akademik. |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Në përfundim të çdo semestri, realizohet monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe i performancës të çdo personeli akademik. Kjo arrihet përmes anketimeve të ndryshme që zhvillohen me pjesëmarrjen e studentëve të UV. Universiteti garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve nëpërmjet:<br>-Sigurimit të së drejtës së studentit për ankimimin e rezultatit të vlerësimit të dijes sipas procedurës së përcaktuar në Rregulloren e UV[120], rregulloren e DE[121] dhe rregulloren e PS[122].<br>-Pjesëmarrjes së studentëve në procesin e anketimit për çdo lëndë, çdo fund semestri; |

[117] Evidenca N-Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe innovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve
[118]Evidenca B-Plani Strategjik 2018-2024, faqa 31
[119] Evidenca III.1-Vendimi e Senatit Akademik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Nr. 84 datë 12.12.2016.
[120] Evidenca C- Rregullore e UV-së e ndryshuar Kreu VII, Neni 62.
[121] Evidenca I.3-Rregullorja e Departamentit të Edukimit
[122] Evidenca I.5- Rregullore e programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor", neni 15

| | |
|---|---|
| | -Pjesëmarrjes së studentëve në procesin e përmirësimit të instrumenteve të vlerësimit[123]. |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Përfundimet e marra kanë shërbyer si një mekanizëm alternativ vlerësues për performancën dhe aftësitë e pesonelit akademik kryesor dhe atij ndihmës. Përfundimet e anketimit janë botuar në faqen zyrtare web të insitucionit[124]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies. | UV, në fund të çdo viti akademik, përpilon Raportin Vjetor[125] sipas Udhëzimit Nr.5, datë 19.02.2018 "Për Përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të Arsimit të Lartë". Departamenti i Edukimit organizon çdo vit analizë vjetore të punës, bazua, në këtë material institucional, si dhe në raportin e analizës së pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë të mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, së bashku me rekomandimet përkatëse, ku një nga pikat e së cilës është edhe analiza e cilësisë së mësimdhënies[126]. Në fund të çdo viti akademik, Drejtuesi i Departamentit të Edukimit realizon vlerësimin e performancës së secilit anëtar të departamentit. UV në mënyrë të vazhdueshme promovon shembuj të praktikave të mira, nxit e inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies e kërkimit shkencor nëpërmjet mbështetjes financiare. Shembull i kësaj mbështetjeje është rimbursimi i shpenzimeve për kërkimin shkencor (pjesëmarrje në konferenca shkencore e publikime në revista shkencore) të cilën e kanë përfituar pedagogët e Departamentit të Edukimit, në përbërje të të cilit është edhe programi i studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"[127],[128], apo dhe evidentimi i personelit akademik të disa prej pedagogëve të këtij departamenti, për kontributin e vyer në UV me rastin e 25 vjetorit të krijimit të UV |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[123] Aneksi 1: Tabela 24.
[124] Publikim Raporti në Web: https://univlora.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-raportit-te-analizes-sepyetesoreve-te-studenteve/
[125] Evidenca J- Raporti Vjetor i UV për vitin 2018-2019
[126] Evidenca III. 5 -Plani i masave për raportin e analizës dhe vlerësimit të pyetësorit prej GSBC Departamenti Edukimit
[127]Evidenca I-Raport Vjetor i UV për vitin 2017-2018
[128] Evidenca J-Raport Vjetor i UV për vitin 2018-2019

| Standardi III.2<br>**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, laboratorët, detyra kursit/esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Programi "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor" zhvillohet përmes ndjekjes prej studentëve janë leksionet, seminaret, detyrat e kursit, praktika në terren dhe tema e diplomës.Të gjitha këto forma të mësimdhënies janë të përcaktuara në Rregulloren e programit të studimit dhe pasqyrohen në çdo syllabus të lëndëve[129].<br>Stafi akademik i Departamentit të Edukimit përdor mjete dhe forma të larmishme të mësimdhënies, siç janë mjetet audio-vizive, përfshirja interaktive e studentëve gjatë orëve të mësimit, angazhimi i tyre në diskutimin e rasteve të studimit, kërkim dhe punë individuale apo në grup[130], kurse format kryesore të kontrollit të dijeve janë aktivizimi gjatë orëve mësimore, testimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe e projekteve të kursit, mbrojtja e detyrave të praktikës në terren, provimi final, mbrojtja e temës së diplomës[131]. |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. | Nga shqyrtimi i programeve lëndore që ky program studimi mbulon, si edhe nga bisedat me studentët, u konstatua që stafi akademik përdor metoda të mësimdhënies të cilat kanë në qendër studentin, ku mund të veçohen diskutimet, puna me grupe, etj. Këto metoda mundësojnë zhvillimin e shprehive të të menduarit kritik dhe krijues, duke aftësuar tek studentët edhe zhvillimin e kompetencave për zgjidhjen e problemeve që mund të ndeshen në jetën reale.<br>Në Rregulloren e Departamentit të Edukimit, neni 14, si dhe në Rregulloren e Programit të Studimit, neni 15, shprehet se puna mësimore me studentët përfshin një larmi formash të mësimdhënies, mësimnxënies dhe të kontrollit të dijeve. Ka një përdorim në vitet e fundit përgatitja e leksioneve në formatin "ppt" dhe me forma audiovizive, me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.[132] |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme | Personeli kryesor akademik dhe ai ndihmës zhvillon lëndë në përputhje me kualifikimin dhe kërkimin shkencor të tyre. Në bazë të rezultateve të marra nga kërkimet shkencore apo nga kualifikimi i mëtejshëm i personelit akademik[133], është përmirësuar procesi mësimor në të gjithë elementët e tij si edhe ky proces është harmonizuar me nevojat bazë të të nxënit të studentëve. |

[129] Evidence I.3 - Rregullore e Departamentit të Edukimit, Neni 14, Pika 14/4, a,b,c
[130] Evidenca III. 6 - Strategjia e zhvillimit të FSHH, 2016-2020
[131] Aneksi 1: Tabela 13
[132] Evidence I.3 -Rregullore e DE, Kreu IV, Neni 14
[133] Aneks I: Tabela 7 "Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre"

| | |
|---|---|
| e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. | |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. | Personeli kryesor akademik dhe ai ndihmës përdor metoda të shumëllojshme gjatë zhvillimit të orëve mësimore, të tilla si diskutim me studentët me qëllim zhvillimin e procesit të të menduarit kritik dhe krijues, zhvillimit të projekteve në grup ose në mënyrë individuale. Kompetenca e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie vërtetohet edhe nga rezultatet e pyetësorëve të studentëve, ku më shumë se 97.8%[134] e studentëve konfirmojnë vlerësimin mirë dhe shumë mirë për pyetjet që lidhen me aftësitë dhe të qënit kompetent të stafit akademik. Avancimi i mëtejshëm i stafit akademik përmes aktivitetit kërkimor shkencor në fushën përkatëse, plotëson kompetencat mësimdhënëse.Stafi që jep mësim në këtë program studimi kategorizohet si vijon:[135],[136],[137]., në Profesorë, Profesorë të asociuar , Doktorë shkencash dhe Master i Shkencave |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, si edhe nga bisedat jo vetëm me stafin akademik të angazhuar në programin e ciklit të parë "Bachelor" në "Mësuesi në Arsimin Fillor", por edhe me studentët e këtij programi, u konstatua se institucioni kishte mekanizma dhe instrumente[138]që mblidhnin të dhëna për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies, formateve të vlerësimit, si edhe të teknikave që përdornin për procesin e të nxënit. |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. | Personeli kryesor akademik dhe ai ndihmës ka synuar gjithnjë zbatimin e metodave të mësimdhënies[139] që kanë në qendër studentin. Këtu janë promovuar metoda interaktive të mësimdhënies si edhe janë përdorur gjerësisht rastet studimore, përmes të cilave u është dhënë mundësia studentëve që të bëhen pjesë reale e veprimtarisë mësimore. |
| **Kriteri 7.** Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes | Nga shqyrtimi i programeve lëndore evidentohen forma dhe metoda të mësimdhënies të cilat inkurajojnë sensin e autonomisë së studentit. Studentet angazhohen dhe janë të pavarur në realizimin e detyrave individuale dhe në grupe përgjatë gjithë procesit mësimor (neni 19 pika c, d)[140]. Përgjatë kohës së punës për këto detyra, studenti mbështetet me udhëzime dhe orientime prej pedagogut të lëndës, si nëpërmjet komunikimit të drejtëpërdrejtë gjatë orës së mësimit, gjatë orarit zyrtar me |

[134] Evidenca L- Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019.
[135] Aneks I: Tabelat 6.1,6.2,6.3,6.4; "Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit" ;
[136] Aneks I: Tabela 7 "Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre"
[137] Aneks I: Tabelat 12 "Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës
[138] Aneksi 1: Tabela 24.
[139] Evidenca III.7- Mobilitet stafi për trajnim dhe mësimdhënie
[140] https://univlora.edu.al/ëp-content/uploads/2020/01/Vendim-Nr.-18-Dt.-09.01.2020.pdf

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| tyre. | studentin, por edhe nëpërmejt komunikimit elektronik përmes postës elektronike zyrtare të pedagogut dhe studentëve. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.3**<br>**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. | I gjithë procesi mësimor i Programit të studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor" zhvillohet në mjediset e Fakultetit të Shkencave Humane (FSHH). Mjediset përmbushin standardet në fuqi që duhet të plotësojë një IAL sa i përket infrastrukturës fizike[141] Personeli ndihmës garanton mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe siguron standardet e nevojshme sanitare. |
| **Kriteri 2.** Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor. | Të gjitha mjediset e FSHH janë mjedise funksionale sa i përket formës fizike dhe janë të pajisura me të gjithë logjistikën e nevojshme si banka, karrige, tabela të llojeve të ndryshme, pajisje audiovizive, videoprojektorë, si edhe shërbim i pandërprerë interneti. |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. | Në shërbim të të gjithë personelit akademik, komunitetit studentor, por edhe atij ndihmës, është në dispozion një infrastrukturë e mjaftueshme IT, që mundëson komunikimin online, shpalljen e rezultateve të vlerësimit, si edhe shfrytëzimin online të materialeve didaktike. |
| **Kriteri 4.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. | Të gjitha lëndët e Programit të studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor" zhvillohen në gjuhën shqipe. Në dispozicion të studentëve është literatura bazë në trajtën e leksioneve, dispensave, si edhe teksteve të miratuara në njësinë bazë[142]/[143]. Rregullorja së UV-së, Neni 49 paraqet kriteret për përcaktimin e teksteve mësimore të rekomandueshme për pjesën teorike dhe të detyrueshme për seminaret, ushtrimet dhe detyrat praktike, te cilat duhet të miratohen nga departamenti, me propozimin e titullarëve të lëndëve.<br>Literatura bazë dhe ndihmëse e përcaktuar në programin lëndor [144] të secilës prej lëndëve të programit të studimit Bachelor në |

[141] Aneksi 1: Tabela 16, 21
[142] Evidenca C- Rregullore e UV –së e ndryshuar, Neni 49, Tekstet mësimore.
[143] Evidenca I. 6 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite
[144] Evidenca I. 6 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite

| | |
|---|---|
| | "Mësuesi për Arsimin Fillor". Përveç literaturës bazë, studentëve u sugjerohet edhe literaturë ndihmëse, e cila është përzgjedhur nga njësia bazë dhe është në gjuhën shqipe dhe angleze. |
| **Kriteri 5.** Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. | UV ka dy biblioteka të cilat garantojnë një numër të konsiderueshëm botimesh të viteve të fundit[145], në drejtimet kryesore të programit të studimit. Ndërkohë UV ka marrë disa masa konkrete për realizmin e bibliotekës online me qëllim garantimin e një numri të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit që lidhen me programin e studimit. Bibliotekat kanë hapësira të mjaftueshme dhe të përshtatshme për përdorim nga studentët për studim dhe bërje të detyrave të kursit. |
| **Kriteri 6.** Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. | UV në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, e mbështetur nga MASR, ka mundësuar për personelin akademik dhe studentët shërbimin e bibliotekës on-line "*ULIBRARY*"[146]. Në faqen Web të UV-së, personeli akademik dhe studentët kanë mundësi të aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit duke ndjekur udhëzimet e manualit[147] përkatës |
| **Kriteri 7.** Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. | UV ka vënë në dispozicion të zbatimit të programit bachelor në Mësuesi për arsimin fillor mjediset e godinës B[148] të FSHH, ku në katin e katërt të saj funksionon një laborator i gjuhëve të huaja që mundëson që një pjesë e leksioneve të realizohen në këtë laborator, duke përdorur programe specifike sipas kërkesave të lëndëve. Në katin e parë po ashtgu funskionon një laborator për Pedagogjinë e Specializuar dhe një tjëtër laborator për Edukimin Artistik për studentët e Arsimit Fillor dhe Edukimit Parashkollor.Mjesdisi I UV ka mundësi për përdorim të internet (Wi-fi) falas. |
| **Kriteri 8.** Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre. | Si në të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, edhe në UV, mësimi përgjatë vitit 2020 po zhvillohet përmes përdorimit të platformave të dedikuara të mësimdhënies për mësimin online, siç është platforma "Google classroom & Google meet". Ndërkohë, UV nëpërmjet platformës elektronike UVMS, realizon komunikimin e personelit akademik të UV-së me studentët për secilën prej lëndëve të planit mësimor të programit të studimit. Kjo realizohet falë hapësirës personale (account) të secilit përdorues të këtij sistemi. Platforma elektronike UVMS[149], ndër të tjera shërben edhe për të patur akses në dokumentacionin elektronik (p.sh. shkarkimi i faturave të ndryshme). Aksesi në këtë |

[145] Evidenca III.9- Informacion per Bibliotekën, Lista e librave të Bibliotekës të përditësuara sipas fushave, Loti 3.
[146] https://ulibrary.rash.al/
[147] Manuali i aksesit në bibliotekën on-line. https://ulibrary.rash.al/manual.pdf
[148] Evidenca II. 7- Kapacitetet fizike të FSHH-së
[149] Evidenca III.8- Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjise së informacionit MANUAL-PERDORIMI-UVMS-PEDAGOGE

| | |
|---|---|
| | dokumentacion bëhet nëpërmjet përdorimit të hapësirës vetjake të dedikuar[150] për secilin përdorues të UVMS ose përdorimit nga adresa elektronike personale zyrtare (emer.mbiemer@univlra.edu.al). Secili staf i departamentit që është i angazhuar në mësimdhënie në programin Bachelor ka llogarin e vet në UVMS ku komunikon me studentët e kursit. Nga bisedat e realizuara me stafin e programit, u konstatua se si stafi akademik, ashtu edhe studentët, kishin marrë trajnime për zhvillimin e kompetencave të tyre digjitale, në mënyrë që ky proces të realizohet sa më cilësisht. |
| **Kriteri 9.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar. | Nga dokumentacioni i dorëzuar, u konstatua që UV ka një sistem funksional operimi UVMS[151]. |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. | Studentët e Programit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor" e realizojnë procesin e mbrojtjes së diplomës përmes temave të studimit ose përmes provimit të formimit. Fusha e studimit dhe e kërkimit përcaktohet në Rregulloren e Programit të Studimit dhe me vendim të njësisë bazë[152]. Studentët njihen me temat e kërkimit dhe më pas kanë të drejtë të zgjedhin fushën që ata dëshirojnë si edhe pedagogun udhëheqës. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.4**<br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me | Në UV funksionojnë struktura në funksion të promovimit të cilësisë, të tilla si: NJSBCVI, Komisionet e Përhershme: të sigurimit të cilësisë së brendshme në nivel institucioni, fakulteti; komisionet e marrëdhënieve me studentet në nivel institucional dhe fakulteti[153], të cilat në fokus të veprimtarisë së tyre kanë rritjen e kulturës së cilësisë me qëllim përmirësimin e cilësisë së |

[150] https://uvms.univlora.edu.al/user/login
[151] Evidenca III.8- Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjise së informacionit MANUAL-PERDORIMI-UVMS-PEDAGOGE

[152] Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësues pë Arsimin Fillor" Neni 19.
[153] Evidenca A - Statuti i UV, neni 22;fq. 80-82

| | |
|---|---|
| njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. | mësimdhënies |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron. | Fakulteti i Skencave Humane dhe Deparatamenti i Edukimit kryejnë përgjegjësitë institucionale për ritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të të nxënit, por dhe për rritjen e vetëdijes së stafit për këtë program bazuar kryesisht te Raporti i rezultateve të pyetësorëve si dhe rekomandimet e përpiluara prej NJSBCVI-së.Në këto njësi zhvillohen konsultime të gjera me stafin akademik, duke e bërë të gjithë procesin e përmirësimit të programit të studimit nëpërmjet pyetësorit të studentëve transparent dhe gjithëpërfshirës, por dhe duke rritur njëkohësisht vetëdijen e personelit akademik dhe studentëve për cilësinë në programet e studimit që ofron.<br>Studentët janë përfshirë jo vetëm në plotësimin e pyetësorit, por edhe si aktorë në procesin e ngritjes së kulturës së cilësisë, duke i angazhuar në fushatat informuese dhe promovuese për Plotësimin e Pyetësorit të Studentëve për Vlerësimin e Cilësisë së Mësimdhënies, Sondazhit Kombëtar të Studentëve, si dhe në grupe të ndryshme të ngritura me qëllim përpilimin ose rishikimin e instrumentave të vlerësimit të brendshëm[154], si dhe në grupe të ndryshme të ngritura me qëllim përpilimin ose rishikimin e instrumentave të vlerësimit të brendshëm[155]. |
| **Kriteri 3.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. | Nga bisedat me pedagogët, si edhe me studentët, u konstatua se në situatën e pandemisë në vitin 2020, por jo vetëm, në dispozicion të të gjithë stafit akademik janë vendosur manuale të mësimit online me anw tw plafromws "Google classroom & Goole meet". Në nivel institucioni është ngritur Qendra Studimore Ndërdisiplinore për Zhvillimin Rajonal (RDC), ku një prej qëllimeve të saj është mbështetja e metodave eksperimentale bashkëkohore. Një produkt i kësaj qendre është dhe Udhëzuesi[156] mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e | Personeli akademik i Departamentit të Edukimit kualifikohet në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor[157] për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies falë edhe |

[154] Aneksi 1: Informacion nga NJBSCVI, faqe 9, tabela me të dhënat për studentët e përfshirë në NJBSCVI apo aktivitetet e saj.

[155] Aneksi 1: Tabela 24.

[156] Evidenca N - "Udhëzuesi mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe innovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit".

[157] Aneksi 1: Tabela 19.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | suportit të UV-së i cili i ka mbështetur në pjesëmarrje të stafit në projekt[158], seminare, trajnime, Workshop-e dhe konferenca shkencore. | | | |
| **Kriteri 5.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. | Përmes Qëndrës Studimore Ndërdisiplinore për Zhvillimin Rajonal (RDC), Departamenti i Edukimit synon që të përmirësojë një lidhje në vazhdimësi me mësues të arsimit përmes strukturave të mësimit përgjatë gjithë jetës. Konkretisht RDC ka organizuar dhe zbatuar projektin TEAVET, në drejtimin e seancave të tij ishin pjesë nga stafi i Departamenti të Edukimit [159/160]. | | | |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. | Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik i programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Kjo sanksionohet në Rregullore e UV- së, Statut, Rregullore e FSHH, Rregullore e Departamentit të Edukimit, dhe Rregullore e Programit të Studimit. | | | |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik synon zbatimin e metodave të larmishme në procesin mësimor dhe i analizon gjithmonë këto në mbledhjet e njësisë bazë. Stafi akademik përdor një sërë instrumentesh për testimin e efektivitetit të metodave të reja të aplikuara në mësimdhënie si: feedback i drejtpërdrejtë i marrë nga studentët në auditor; rritja e cilësisë së studentëve (rezultatet akademike); krahasimi i rezultateve vjetore të rezultateve të pyetësorëve të studentëve.[161] | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve | UV ka hartuar dokumente rregullore[162/163], transparente që normojnë kriteret, mënyrën e vlerësimit, si edhe njohjen e tyre |

[158] Evidenca III.7- Mobilitet stafi për trajnim dhe mësimdhënie.
[159] Aneksi 1: Tabela 2
[160] Aneksi 1: Tabela 12.1, 12.4
[161] https://univlora.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-raportit-te-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve/
[162] Evidenca C- Rregullore e UV-së e ndryshuar, Kreu VII Kontrolli i dijes dhe Kreu VIII, Neni 65.
[163] Evidenca I.5.Rregullore e programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor", Kreu III, Neni 14, 15

| | |
|---|---|
| dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | prej studentëve. Studentët njihen me procedurat e mësipërme nga titullari i lëndës gjatë momentit të prezantimit të syllabusit. Gjithashtu, studentëve u mundësohet në mënyrë të vazhdueshme edhe ndihma e ofruar nga Koordinatori/këshilltari i Programit të Studimit[164]. |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Referuar paketës[165] së programeve lëndore, që institucioni ka dorëzuar, si edhe nga bisedat e zhvilluara me studentët e programit "Bachelor"[166] në "Mësuesi për Arsimin Fillor", konstatohet se stafi akademik që mbulon disiplinat e këtij programi, ka të pasqyruar qartë në progamet lëndore dhe informon studentët, për formatet e procesit të vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimin përfundimtar. |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit kurrikular të programit të studimit dhe bisedat me studentët rezulton se përpara fillimit të lëndës/modulit çdo pedagog i paraqet studentëve syllabusin e lëndës së bashku me modalitet e përfshira në të si mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore e cila realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme[167], me shkrim me gojë apo të kombinuara, duke i dhënë mundësi studentit<br>të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara, në zbatim të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë;[168] Rregullores së Departamentit[169] dhe Rregullores së Programit të Studimit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.6**<br>**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik. | Programi i Studimit planifikon dhe realizon testimin e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale për studentët realizohet gjatë gjithë vitit akademik (në fund të sezonit të semestrit "vjeshtë" dhe "pranverë") dhe në zbatim të: Rregullores së "Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë[170] dhe Rregullores së |

[164] Evidenca C-Rregullore e UV-së e ndryshuar, Kreu IX, Neni 71.
[165] Evidenca I.6 - Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite
[166] Evidenca I.5-Rregullore e programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor", Kreu III, Neni 8, pika d.

[167] Aneks 1. Tabela 13.
[168] Evidenca C- Rregullore e UV-së e ndryshuar, Kreu VII, Neni 61.
[169] Evidenca I.3-Rregullore e Departamentit të Edukimit, Kreu IV, Neni 15, pika 15/1, 15/2
[170] Evidenca C- Rregullore e UV e ndryshuar, Neni 45, Neni 61, Neni 63 dhe Neni 65.

| | |
|---|---|
| | Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"[171] si dhe kalendari i provimeve të vitit akademik.[172].Në raste specifike, të parashikuara në këto rregullore, duke ndjekur një procedurë të veçantë, studentëve u ofrohet mundësia prej Dekanit të fakultetit të realizojnë provimin (e pjesshëm/përfundimtar) ose provimin e diplomës, duke hapur data të posaçme provimi. Vlerësimi i njohurive për Programin "Bachelor" në lëndët dhe modulet e "Mësuesisë për Arsimin Fillor" realizohet përgjatë gjithë vitit akademik përmes vlerësimit të vazhduar, vlerësim që përbën 20%-30% të vlerësimit përfundimtar, konform përcaktimeve në programet lëndore. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | UV ka ofruar, i pari nga universitetet shqiptare, një platformë elektronike interaktive për studentët[173], për stafin akademik dhe atë administrativ për menaxhimin e informacionit të prodhuar nga stafi akademik në lidhje me rezultatet e vlerësimit të dijeve (UVMS).[174]. Kjo platformë e ka përmirësuar transparencën dhe zvogëluar ndjeshëm format dhe mundësitë e abuzimit në lidhje me vlerësimin, duke krijuar lehtësi për informimin në kohë sa më të shpejtë të studentëve. Aktualisht, në UV, nuk ka në zbatim një sistem elektronik testimi dhe vlerësimi të studentëve avantazhet e të cilit do të rrisnin transparencën dhe mundësonin reduktimin në maksimum të abuzimit dhe subjektivitetit në vlerësimin e studentëve |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. | U konstatua se në zbatim të Rregullores së Programit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"[175], testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale për studentët të cilët ndjekin programin bëhet nga komisionet e provimeve[176] me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit dhe vetëm komisioni i provimit të diplomës përbëhet prej 5 anëtarësh. Këto komisione përcaktohen prej Drejtuesit i Departamentit të Edukimit, në zbatim të rregullores së këtij programi studimi[177] dhe bëhen publike të paktën dy javë përpara datës së përcaktuar për kontrollin e dijes. |
| **Kriteri 4.** Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet | Nga shqyrtimi i RVB-së, u konstatua, se në UV, testimi i vlerësimit të njohurive[178], dijeve me shkrim, nuk zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim, por eshtë e |

[171] Evidenca I.5-Rregullore e Rregullore e programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor", Kreu III, Neni 8, pika d.

[172] Evidenca III.10- Kalendari i provimeve të vitit akademik

[173] Evidenca III.8-Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit

[174] UV është ndër të parat universitete publike që ka implementuar sisteme të menaxhimit të informacionit prej vitit 2008 (Sistemi Informativ i Universitetit të Vlorës-SIUV), i cili u zhvillua dhe u zëvendësua nga SMI-Univlora (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit) dhe që operoi gjatë periudhës 2011-2016, duke adoptuar më pas për vitin akademik 2016-2017 sistemin e menaxhimit të informacionit ESSE3 dhe duke iu rikthyer një vit më vonë (217-2018 e në vijim) sistemit aktual. (RVB Univlora 2017, fq. 23).

[175] Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor", Kreu III, Neni 17

[176] Evidenca III.10- Kalendari i provimeve të vitit akademik

[177] Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"

[178] Evidenca C- Rregullore UV e ndryshuar, Nenet 60-63.

| | |
|---|---|
| në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi. | parashikuar në rregulloret e UV-së procedura e ankimimit të vlerësimit. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për mbarëvajtjen e provimit deri në shpalljen e rezultateve për studentët. Rregullore e UV-së parashikon procedura strikte në lidhje me afatet e editimit të rezultateve të provimit në sistemin UVMS. Po ashtu, institucioni siguron infrastrukturën e posaçme të monitoruar me personel (komision për zhvillimin e procesit të provimit). |
| **Kriteri 5.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Nga bisedat me studentët, u konstatua se përgjatë vitit shkollor ata përgjithësisht marrin feedback të llojeve të ndryshme prej pedagogëve. Pas përfudimit të çdo provimi apo formave të tjera të kontrollit të dijeve, rezultatet shfaqen në UVMS jo më larg se 48 orë nga dita e zhvillimit të tij[179]. Pas shpalljes së rezultateve, studentëve u jepet e drejta që të shikojnë individualisht tezat e korrigjura prej pedagogut, duke pare në këtë mënyrë vlerësimin për secilën përgjigje të tyre dhe të paraqesin ankesat e tyre në lidhje me vlerësimin nga ana e pedagogut. Kjo e drejtë e studentëve garantohet në rregulloren e universitetit,[180] dhe rregulloren e këtij programi studimi, shoqërohet me komente / feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. |
| **Kriteri 6.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik. | Rastet e kopjimit dhe të së drejtës së autorit trajtohen në Kodin e Etikës të UV[181], ku pasqyrohen me detaje elementët e këtyre rasteve, së bashku me ndërshkimet përkatëse. Kështu, nëse studenti kapet duke kopjuar nga komisioni i provimit, ai përjashtohet menjëherë nga provimi dhe shpallet jokalues në atë lëndë[182]. |
| **Kriteri 7.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Departamenti ka përcaktuar edhe procedurën dhe afatet e bërjes publike të rezultateve të vlerësimit. Kështu, afati për provimet është 48 orë. Çdo vonesë në dhënien e rezultateve të vlerësimit e ngarkon komisionin me përgjegjësi administrative[183].Kur ka ankimim student, i jepet lihet dhe 24 orë të tjera, sipas procedurës së parashikuar në rregulloren e universitetit[184] dhe notat finale rejgitsrtohen pas 72 orës sipas rregullores së programit te studimit[185] |
| **Kriteri 8.** Institucioni | U konstatua se çdo student ka të drejtë që të kërkojë sqarime për |

179 Evidence 1.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"
180 Evidenca C- Rregullore UV e ndryshuar, Kreu VII, Neni 61.
181 Evidenca E- Kodi i Etikes i Universitetit "Ismail Qemali" Vlore, Neni 8, pika 6 dhe 8, Neni 9, pika 8 dhe 9. Evidenca E- Kodi i Etikës, Neni 8, pika 5.
182 Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor", Kreu III, Neni 15

183 Evidenca E- Kodi i Etikës, Neni 8, pika 5.
184 Evidenca C- Rregullore UV e ndryshuar, Kreu VII, Neni 61.
185 Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor", r, Kreu III

| | |
|---|---|
| garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | çdo gjë që ai e sheh si jo të arsyeshme, ose të kundështojë rezultatin brenda 48 orëve[186]. Komisioni i provimit ka detyrimin që të sqarojë studentin, duke ballafaquar përgjigjen e studentit me çelësin e tezës së provimit. Vetëm pas kësaj nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin që të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit. |
| **Kriteri 9.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet. | U konstatua se çdo kërkesë, ankimim në lidhje me saktësinë dhe korrektësinë e vlerësimit të dijeve nëpërmjet të gjitha formave të kontrollit, parashikohet hollësisht në rregulloren e universitetit, programit të studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"[187], si dhe në Rregullorën e FSHH[188], Ankesa e dorëzuar pranë Drejtuesit të Departamentit të Edukimit (në rastet e pazgjidhura brenda njësisë) i përcillet Dekanit të fakultetit, brenda 48 orëve nga marrja në dijeni për ankesën. Dekani ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të Dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. Kur studenti pretendon se ka konflikt me pedagogun e lendes, mund ti kërkoi drejtuesit të njësisë bazë ndryshim të komisionit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.7**<br>**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët,duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Në Rregulloren e Programit të Studimit[189] janë përcaktuar qartë objektivat e këtij programi studimi, të cilat synojnë ofrimin e njohurive të përgjithshme dhe specifike, të mbështetura në lëndë të formimit bazë, karakterizuese, ndërdisplinore, si edhe plotësuese, si edhe përgatitjen e mësuesve të arsimit fillor të aftë që të integrohen në proceset e mësimdhënies, si në shkolla fillore, ashtu edhe në institucione me karakter specifik në fushat përkatëse. *Nga diskutimet e me ekipin e pedagogëve të programit u evidentua se procesi dhe metodologjia e hartimit të programit të studimit duhet të ketë më shumë bashkëpunim me institucionet kurrikulshkruese, por dhe me zhvillimet aktuale që ndodhin në kurrikulën e zbatuar në shkolla të ciklit fillor me qasje* |

[186] Evidenca C- Rregullore UV e ndryshuar, Kreu VII, Neni 61 dhe 62.
[187] Evidenca C- Rregullore UV e ndryshuar, Kreu VII, Neni 62.
[188] Evidencë 1.7-Rregullore e FSHH, Kreu V, Neni 41
[189] Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"

| | |
|---|---|
| | *kompetencash (klasat 1-5), gjë e cila duhet të reflektohet dhe në dokumentaiconin e programit për formimin e duhur, profesional të mësuesit të arsimit fillor.* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Në Rregulloren e Programit të Studimit[190], në synimet e saj, parashikohet pajisja e studentëve me elementët bazë të shprehive të kërkuara në lidhje me teknologjinë e informacionit, si edhe pajisjen e nxënësve me elementët bazë të etikës profesionale në fushën e komunikimit dhe të marrëdhënieve sociale. |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde. | Nga analiza e programeve lëndore të këtij programi studimi, konstatohet një ndërthurrje e elementeve teorike me kompetencat profesionale të duhura që duhet të zotërojë një mësues i arsimit fillor, duke i vënë theksin formimit të tij për të plotësuar zhvillimin konjitiv, psikologjik, social, si edhe emocional të fëmijëve që frekuentojnë ciklin e arsimit nga klasa I deri IV. Për analizën dhe përmirësimin e përmbajtjes së programeve lëndore, Deparatementi i Edukimit zhvillon dhe veprimtari me pedagogë, studentë për të vjelë mendimet e tyre, për një përmirësim të vijueshëm të programeve.[191] |
| **Kriteri 4.** Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre. | U konstatua se vlerësimi i kompetencave në përfundim të procesit mësimor bëhet nga pedagogu përgjegjës apo titullari i lëndës/modulit. Në përfundim të semestrit akademik, personeli akademik realizon orë të veçanta konsultuese gjatë të cilave studenti orientohet mbi implementimin në praktikë të çështjeve më të rëndësishme, si dhe çdo pyetje që ata mund të kenë mbi lëndën përkatëse. Vlen për tu theksuar se personeli akademik parashikon në syllabuset e lëndëve organizimin e ditëve të caktuara konsultuese me studentët. [192] |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. | Stafi akademik ka realizuar edhe orë të hapura në nivel Fakulteti ku janë organizuar disa leksione të hapura: nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë[193].Departamenti i Edukimit ka parashikuar në strategjinë dhe te programi i studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" të ogranizojë leksion të hapur nga ekspertë të fushës së mësimdhënies dhe kurrikulës. |
| **Kriteri 6.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në | Mësimdhënia tek lëndët e planit mësimor për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" realizohet prej stafit akademik mbi bazë kompetencash, në mënyrë të veçantë tek lëndët të cilat u japin studentëve mundësi të |

[190] Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" r, Kreu III
[191] https://univlora.edu.al/2019/12/22/ëorkshop-me-teme-studentet-dhe-tregu-i-punes/
[192] Evidenca I.6 -Programet e lëndëve (Syllabuset)
[193] Evidencë III.11- Leksion i hapur.

| | |
|---|---|
| laboratorë dhe praktikat profesionale. | zhvillojnë njohuritë e marra në auditor, por edhe jashtë tij (praktikat profesionale)[194]. |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara. | Personeli akademik i Departamenti të Edukimit mbështet diskutimet dhe punën në grup të studentëve në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara duke krijuar kushtet dhe favorizuar organizimin e punës në grup gjatë orëve të seminareve dhe studimit individual. |
| **Kriteri 8.** Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve. | Personeli akademik i Departamentit të Edukimit krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve, si për shembull nëpërmjet konferencave studentore që UV ka organizuar[195]. |
| **Kriteri 9.** Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët. | Personeli akademik i mbështet studentët në mënyrë të vazhdueshme për punët e tyre, kërkimore, shkencore, ku përmendim mbështetjen gjatë publikimit të "Buletini Studentëve" të FSHH. Deri më tani financimi në nivel institucioni ka qenë modest, sepse Këshilli Studentor, i cili është struktura përgjegjëse për përcjelljen e kërkesave studentore për financim në UV, është krijuar rishtazi. *Nga ana tjetër, gjatë bisedave me studentët dhe pedagogët u evidentua se duhet punuar më shumë për përfshirjen e studentëve në procese kërkimore që lidhen ne fushën e tyre të formimit.* |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Personeli akademik i Departamentit të Edukimit ka marrë pjesë gjerësisht në aktivitete ndërkombëtare dhe në bashkëpunimet që UV ka patur si partner në projekte ndërkombëtare përfshirë këtu edhe ato ERASMUS +, nëpërmjet të cilave është mundësuar mobiliteti i stafit akademik[196], *por nga ana tjetër vihet re mungesë e shfaqjes së interesit nga ana e studentëve për t'u përfshirë në mobilitete studimi/ praktikë mësimore megjithëse ka pasur thirrje të hapura për aplikim në fushën e edukimit*[197]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi III.8**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

194 Evidenca I.6 -Programet e lëndëve (Syllabuset).
195 https://univlora.edu.al/2017/12/15/konferenca-studentore-e-hapur-2017/
196 Evidenca III.7- Mobilitet stafi per trajnim dhe mësimdhënie
197 https://univlora.edu.al/2019/12/03/bursa-erasmus-per-studentet-ne-universitetin-aurel-vlaicu-te-aradit-rumani/

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. | Nga shqyrtimi i RVB dhe bisedat me studentët dhe stafin e programit, rezulton se Provimi final ose mbrojta e diplomës për studentët e programit e ciklit të parë Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor", realizohet sipas procedurës të përcaktuar në Nenin 14 dhe 15 të Rregullores së këtij programi studimi. Kjo procedure bëhet publike me publikimin e kësaj rregulloreje si dhe gjatë takimit informues, në lidhje me procesin e diplomimit që realizohet për studentët e vitit të fundit prej Drejtuesit të Departamentit dhe Sekretarisë Mësimore[198]. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. | U konstatua se Sekretaria mësimore, pedagogu udhëheqës i temës së diplomës si dhe pedagogët të cilët kanë hartuar bankën e pyetjeve, asistojnë studentët duke u vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës në respektim të Rregullores[199] së programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"[200]. |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Mbrojtja e diplomës për studentët e programit të ciklit të parë Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" bëhet e hapur[201]. Procedura e mbrojtjes përfshin një provim me gojë ose përgatitja e një teme diplome. Juria dhe kryetari i saj miratohet nga Dekani i Fakultetit me propozim të Drejtuesit të Departamentit dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë. Studentët të cilët provimin e diplomimit e realizojnë nëpërmjet provimit me gojë sipas rregullores së programit të studimit. Ky provim bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë tri viteve të studimit në referencë të bankës së pyetjeve të bëra publike për studentët të paktën 2 muaj përpara provimit të diplomës. Tezat përcaktohen në bazë të orëve mësimorë që janë në auditor dhe krediteve, pyetjet ju përkasin lëndëve të formimit karakterizues. Pikët maksimale që mund të jepen janë 100, ndërsa jepet notë kaluese nëse arrihet kufiri prej 40 pikë. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave. | Personeli akademik i Departamentit të Edukimit i cili harton bankën e pyetjeve të diplomës si dhe udhëheqësit e temave të diplomës[202], orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave duke komunikuar me ta nëpërmjet postës elektronike ose kontaktit të drejtëpërdrejtë |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo | Nga diskutimet e realizuara me studentët gjatë takim virtual në Zoom konstatuam se pedagogët sipas moduleve që ofrojnë asistojnë studentët gjatë e orëve praktike një ditore që ato realizojnë në |

[198] Flisni me skeretaren per Evidencen, nese eshte ne rregullore dhe ku ??
[199] Evidenca I.5- -Rregullore e Programit te Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor",, Kreu III, Neni 15
[200] Evidencë III. 12- Banka e pyetjeve të provimit të formimit për programin Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"
[201] Evidenca I.5- -Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në " Mësuesi për Arsimin Fillor", Kreu III, Neni 15
[202] Evidenca I.5- -Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor",, Kreu III, Neni 19

| | |
|---|---|
| jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | institucionet pritëse me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. |
| **Kriteri 6.** Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Udhëheqësi i diplomës ndjek dhe asiston studentin përgjatë gjithë periudhës së zhvillimit të temës së diplomës dhe miraton paraprakisht punimin[203], duke konkluduar se punimi plotëson të gjitha kushtet formale për t'u paraqitur përpara komisionit. |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | U kosntatua se në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë[204]. Studentët të cilët mbrojtjen e diplomës e realizojnë nëpërmjet provimit me gojë, në përfundim të provimit çdo anëtar i komisionit jep vlerësimin përkatës për çdo student, dhe vlerësimi final i studentit do të jetë mesatarja e thjeshtë aritmetike e vlerësimeve të 5 anëtarëve të Komisionit të Provimit të Diplomës.<br>Studentët të cilët mbrojtjen e diplomës e realizojnë nëpërmjet prezantimit të një teme të punuar prej tyre nën udhëheqjen e një pedagogu, në përfundim të mbrojtes, juria duke marrë në kosnideratë edhe mendimin e udhëhëqësit të punimit të studentit, bën vlerësimin me notë[205]. |
| **Kriteri 8.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. | Në përfundim të studimeve për Programin "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor", studenti pajiset me diplomën përkatëse dhe suplementin e notave, sipas formatit të miratuar nga MASR[206]. |
| **Kriteri 9.** Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Sipas kërkesës së studentit, në përfundim të studimeve atij i vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, në dy kopje: Shqip dhe Anglisht[207] |
| **Kriteri 10.** Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për | Sekretaria mësimore[208] e Fakultetetit dhe Departamentit të UV, mban regjistër bazë të studentëve me të dhënat personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj, të formatuara këto sipas standardeve shtetërore. |

203 Evidenca I.5- -Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor",, Kreu III, Neni 19

204 Evidenca I.5- -Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor",, Kreu III, Neni 15
205 Evidenca III.13-Procedura e diplomimit ne Departamentin e Edukimit
206 Evidenca II.4- Model Diplome dhe Suplementi Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"
207 Evidenca C- Rregullore UV e ndryshuar, Neni 54.
208 Evidenca C- Rregullore UV e ndryshuar, Neni 54.

| | |
|---|---|
| studentin, nëse kërkohen. | Regjistri i studentëve plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahet në ruajtje të përhershme. Sekretaria mësimore e çdo fakulteti apo departamenti përpilon, administron dhe është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit themeltar (bazë) të shkruar me dorë dhe me kompjuter. Regjistri themeltar plotësohet me shkrim, pa korrigjime dhe nuk ndryshohet për asnjë arsye. Përdorimi dhe përpunimi i të dhënave personale të studenteve[209] bëhet prej sekretarisë mësimore në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. UV mban në formë të shkruar:<br>a. regjistrin themeltar të studentëve,<br>b. regjistrin e arritjeve akademike,<br>c. regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Çdo student pajiset me një numër unik matrikullimi, që e mban deri në marrjen e diplomës ose certifikatës, i cili pasqyrohet në këtë regjistër. Regjistri themeltar depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së UV-së. Ai plotësohet edhe në formë elektronike[210].Departamenti depoziton kopje të printuara dhe elektronike të punimeve të diplomës së studentëve, si edhe gjithë praktikat e dokumentacionit të vlerësimit. Gjithë praktika përmbyllëse e programit të studimit mbulohet nga Sekretaria Mësimore e FSHF. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[209] Evidenca C- Rregullore UV e ndryshuar, Neni 90
[210] Evidenca A- Statuti i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Kreu VII, Neni 78

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ. | Konstatuam nga shqyrtimi RVB dhe takimet online nëpërmjet paltformës Zoom se institucioni mbledh dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit akademik sipas nevojave të propozuara nga departamenti. Drejtoria e komunikimit dhe burimeve njerezore[211] menaxhon dosjet e personelit akademik, ndihmës akademik dhe admistrativ si dhe harton dhe ndjekt proceduart për rekrutimet e reja.<br>Departamenti i Edukimit mbledh, ruan dhe përditëson angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik te përfshirë në program dhe personat përgjegjës për organizimin e programit të studimit[212]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. | Konstatuam se DE në bashkëpunim me Drejtorinë e komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore harton dhe zbaton procedura të përgjithshme dhe specifike (të përcaktuara nga departamenti i edukimit) për përzgjedhjen e personelit në përputhje me nevojat e programit[213]. Drejtoria e komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore shpall thirrjen online për vendin vakant, përgatitjen e komisionit të vlerësimit, i cili merr vendimin në bazë të kritereve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe në aktet e brendshme të rregullores së UV[214]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve | Rezulton se çdo fillim viti akademik DE paraqet nevojat e njësisë për staf akademik, mbështetur në plan ngarkesën[215] miratohet në Dekanat dhe i çohet për miratim Senatit akademik dhe Bordit të Administrimit, shoqëruar me arsyetimin përkatës. Më pas Institucioni harton procedura e kritere specifike për rekrutimin e |

[211] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[212] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[213] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[214] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[215] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Fillor- Tabela 4", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| rregullatore dhe i bën ato publike. | personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike[216]. | | | |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Konstatuam se vlerësimi për përzgjedhjen e personelit akademik kryhet nga një komision ad-hoc i ngritur nga Rektori i UV, me 5 anëtar[217]:<br>3 përfaqësues nga vetë departamenti,<br>1 përfaqesues i dekanatit,<br>1 përfaqësues i rektoratit.<br><br>Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-arkivës, ndjek të gjitha procedurat dhe administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të DE[218]. Bazuar ne kuadrin ligjor ajo arkivon dosjet përkatëse për çdo anëtar të PAE dhe PAK, Ndërsa marrëveshjet kontraktuale të organizimit të kohës së punës të stafin akademik arkivohen pranë Drejtorisë së Edukimit. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efiçente dhe efektive** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | Nga shqyrtimi i RVB[219] dhe takimi online me Drejtoria e komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore konstatuam që institucioni zbaton procedura ligjore për përzgjedhjen e personelit në perputhje me nevojat e e programit të studimit.<br>DE në bashkëpunim me Drejtoria e komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore harton procedurat për shhpalljen e thirrjes online, përgatitjes se komisionit të vlerësimit, i cili merr vendimin në bazë të kritereve specifike të përcaktuara nga nevojat e programit të studimit që departamenti ka dhe aktet e brendshme të rregullores së UV[220]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni angazhohet për kualifikimin e | Nga takimi virtual me Përgjegjësen e Departamentit të Edukimit konstatuam se vetë departamenti përditëson në mënyrë të |

[216] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Fillor- Tabela 4", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[217] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 4.1, Procedura e departamentit për personel akademik", ASCAL, Dok. nr.33. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[218] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Procedura e rekrutimit të stafit", ASCAL. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[219] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Fillor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[220] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | vazhdueshme të dhëna që lidhen me aktivitetin kërkimor të stafit akademik[221], CV e tyre akademike, marrëveshja e organizimit të kohës vjetore[222], formularët e parashikimit dhe realizimit të ngarkesës mësimore.<br>Nga ana tjetër Drejtoria e Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të DE[223]. Ajo arkivon dosjet përkatëse të personelit akademik, si dhe të marrëveshjevet e nënshkruara me stafin akademik në përfundim të gjithë procesit të rekrutimit.<br>Stafi akademik është i angazhuar për kualifikim të vazhdueshëm profesional brenda dhe jashtë vendit[224]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | Konstatojmë se institucioni është angazhuar para por edhe gjatë periudhës së pandemisë për kualifikimin e vazhdueshëm[225] dhe zhvillimin profesional të personelit për metodat inovative të mësimdhënies si dhe të përdorimit të teknologjive të reja. UV ka miratur në Janar të vitit 2020 Udhëzuesin mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies[226]. Gjithashtu janë organizuar trajnime për përdorimin e teknonologjive të reja në mësimdhënies si dhe ngritja e sistemit të brendshëm informues UVMS[227]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë. | Institucioni dhe DE dëshmojne të kenë burimeve njerëzore të përthtatshme për përmbushjen e objektivave të programit të studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor" dhe mjedise të përshtatshme për krijimin mundësive të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.<br>DE në çdo fillim viti akademik planifikon kohën vjetore të punës[228] për çdo anëtar të personelit akademik në të cilën përfshihet ngarkesa mësimore, kërkimi shkencor dhe angazhimi institucional në nivel grupi mësimor, departamenti e fakulteti. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

---

[221] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 4.3 Shkresa për miratimin e Strategjisë së kërkimit shkencor 2017-2022,", ASCAL, Dok. nr.35. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[222] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 4.4 Marrëveshje për organizimin e kohës së punës, 2018,", ASCAL, Dok. nr.36. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[223] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Procedura e rekrutimit të stafit", ASCAL. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[224] Universiteti "Ismail Qsemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.8, Mobiliteti i stafit", ASCAL, Dok. nr.29. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[225] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca G, Strategjia Për Trajnimin e Vazhdueshëm të Kërkuesve të Rinj", ASCAL, Dok. nr.55. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[226] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca N, Udhëzues në nivel insitutucional për Zhvillimin dhe përdorimin e Metodave të ndryshme dhe Inovative të Mësimdhënies në Bazë të Fushës së Studimeve, Lëndëve/Moduleve", ASCAL, Dok. nr.62. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[227] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.4, Manual për përdorimin e UVMS-Staf/Student", ASCAL, Dok. nr.25. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[228] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 4.4 Marrëveshje për organizimin e kohës së punës, 2018,", ASCAL, Dok. nr.36. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| **Standardi IV.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Nga vizita virtuale e mjediseve të institucionit konstatuam se lëndët e programit Bachelor MAF zhvillohen në godinen B të Fakultetit të Shkencave Humane.<br>Në shërbim të këtij program studimi, në godinën B janë vënë në funksion 5 klasa leksioni në katin e parë dhe 4 klasa në katin e dytë.<br>2 klasa laboratorike janë vënë në dispozicion për zhvillimin e orëve praktike të kurseve si art muzikor dhe pamor të këtij program studimi[229].<br>Rezulton se institucioni siguron mjediset e përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike sipas grupeve mësimore. |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Konstatuam se disa nga mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, biblioteka janë të pajisura me mjete elektronike të lëvizshme dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Fakulteti i Edukimit ka kapacitet infrastruktoror dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve të programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor", duke përmbushur kështu standardet e kapacitetit infasrtukturor për student.[230] |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Nga vizita virtuale e mjediseve konstatuam se auditorët mësimorë janë të pajisur me mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor (banka, karrike, pajisje audiovizive, tabela etj.). Sallat e leksioneve në të cilat zhvillohen modulet e programit të studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" janë të pajisura me videoprojektorë.<br>2 Laboratori i ngritur, në fazë rikonstruksioni, në mbështetje të këtij program studimi zotëron një sërë mjetesh dhe pajisjesh didaktike të cilat shfrytëzohen nga studentët për të kryer veprimtari të shumëllojshme në orët laboratorike[231].<br>Gjithashtu, gjatë vizitës virtuale në institucion konstatuam se mjediset mësimore si zyra, salle leksionesh, laboratorë, salle konferencash janë të pajisuara me mjetet e nevojshme e të |

[229] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.2, Infrastruktura e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë", ASCAL, Dok. nr. 23 Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[230] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.2, Infrastruktura e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë", ASCAL, Dok. nr. 23 Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[231] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.2, Infrastruktura e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë", ASCAL, Dok. nr. 23 Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| | përshtatshme për plotësimin e kërkesave të kurseve që ofron ky program studimi per aftësimit teorik dhe detyrat praktike formues të programit të studimit. |
| **Kriteri 4.** Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron. | Nga vizita virtuale në institucion dhe nga shqyrtimi i RVB[232] konstatojmë se insitucioni nuk disponon një laborator informatike por brenda bibliotekës së Godinës B ka një kënd me 15 vende të pasjisur me kompjetera.<br><br>*Rekomandohet që insitutcioni të sigurojë për studentët të paktën një laborator të teknologjisë së infomacionit të pajisur me programe profesionale në shërbim të programit të studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. | Institucioni ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë e Vlorës[233] për realizimin e praktikave mësimore të studentëve.<br><br>Gjithashtu institucioni ka realiuar marrëveshje bashkëpunimi me universitete të huaja si: Universiteti i Leçes, Barit, Mesinës, Perugias, Kozencës (Itali), Liezhit (Belgjikë), Kretës (Greqi), Universiteti i Talin-it (Estoni), Universiteti i Turku-t (Finlandë) Universiteti i Vigo-s, Valencia -s (Spanjë), Universiteti i Nish-it (Serbi), Universiteti i Shkencave Natyrore Sofje (Bullgari), Universiteti i Timisoharës (Rumani), Universiteti i Alesundit (Norvegji) etj[234]., në të cilat dhe pedgaogët e Deparatemnti të Edukimit kanë shkëmbyer përvoja profesionale. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Konstatuam se intistucioni ka vënë në dispozicion të studentëve për këtë program studimi dy biblioteka: Biblioteka Qëndrore në godinën A ku ndodhet Rektorati dhe Biblioteka në Godinën B ku ndodhet dhe Fakulteti i Shkencave Humane. Studentët kanë të drejtë të regjistrohen të përdorin literaturën e nevojshme në mjediset e bibliotekave si të tërheqin gjithashtu literaturë për shfrytëzim jashtë mjediseve të bibliotekës[235]. Biblioteka Qendrore ka 15 vende ulëse dhe një pjesë e tavolinave janë të pajisura me kompjutera dhe internet. |

---

[232] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Fillor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[233] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 4.5, Marrëveshje bashkëpunimi DAR Vlorë, 2018", ASCAL, Dok. nr.37. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[234] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Lista e plote e marreveshjeve nder institucionale" Parë në Shkurt 2021, gjendet në https://univlora.edu.al/sektori-projekteve/marreveshje-nderinstitucionale/.

[235] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Fillor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| | Ndërsa nëpërmjet bibliotekës online: Ulilibrary.rash.al studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë literaturën e nevojshme për zhvillimin dhe pasurimin e njohurive teorike dhe realizimin e punëve laboratorike që ofrohen nëpërmjet lëndëve të këtij program studimi. |
| **Kriteri 2.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Nga takimi virtual me Drejtorinë e Bibliotekës dhe bazuar në raportin vjetor të UV rezultoi se biblioteka është e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. Institucioni ka vënë në dsipozicion një fond librash me 21769 libra në gjuhën shqipe, 13974 libra në gjuhë të huaj dhe 2148 periodike në gjuhën shqipe[236]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. | Nga shqyrtimi i RVB rezulton se institucioni në bashkëpunim me MARS ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën online: Ulibrary.rash.al pa pagesë[237]. Studentët dhe stafi akademik kanë mundësi të shfrytëzojnë libaritë online të fushave të ngjashme dhe të përafërta me programin e studimit në mënyrë që të pasurojnë njohuritë teorike dhe realizimin e punëve laboratorike që ofrohen nëpërmjet lëndëve të këtij program studimi. |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | Ne vitin 2017 institucioni ka krijuar një sistem digjital të brendshëm të menaxhimit "UVMS"[238]- Ky sistem elektronik admnistron materialet e hedhura nga stafi akademik për lëndët dhe modulet e ndryshme, materialet shtesë, pikët dhe vlerësimet e studentëve. |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | Nga takimi virtual me stafin akademik dhe studentët konstatuam se studentëve u vihet gjithashtu në dispozicion fondi i librave të DE të cilin pedagogët e shfrytëzojnë si literaturë bazë në programet e moduleve që zhvillojnë. Fond i cili eshte krijuar vit pas viti si rezultat i dhurimeve të ndryshme të bëra nga shtëpitë botuese në vend dhe blerjeve të kryera në kuadër të bashkëpunimit që DE[239].<br>Institucioni ka paraqitur një dokument për tekstet që u vihen në dispozicion studentëve të programit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor, por nuk disponojmë një plan të detajuar stategjik për shtimin e zërave të bibliotekës. |

[236] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019, f.221", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[237] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Fillor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[238] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.6, Vendim Senati nr.101, datë 06.12.2017 Për krijimin dhe funksionimin e UVMS", ASCAL, Dok. nr.27. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[239] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Kopjet e teksteve per dy programet e studimit", ASCAL. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| | *Rekomandojmë që institucioni të hartojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor.* |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Biblioteka e UV ka vënë në dispozicion të studentëve orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, gjatë periudhës para pandemisë dhe gjatë këtij viti akademik biblioteka qendrore ka qënë në dispozocion të nevojave të studentëve nga 08.00- 20.00. Ndërsa Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Humane është në dispozicion të studentëve 08.00-16.00. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Rezulton se institucioni ka vënë në dispozicion sistemin digjital UVMS[240], ku studentët aksesojnë në çdo kohë për ofertat edukative, administative, kulturore dhe sportive[241] etj.<br>Gjithashtu konsatuam që sekretaria mësimore e FFHH disponon statistika vjetore:<br>• për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas progameve të studimit dhe cikleve të studimit[242];<br>• të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit viti akademik;<br>• të dhëna për transferimet dhe çregjistrimet;<br>• të dhëna për ecurinë akademike të studentit;<br>• numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik,<br>• si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen. |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit | Bazuar në Raportit Vjetor të UV[243] rezulton se insitucioni disponon informacion të plotë për aktivitetin mësimor dhe atë kërkimor-shkencor të personelit akademik.<br><br>Zyra e burimeve njerezore disponon dhe arkivon dokumentacionin |

[240] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.6, Vendim Senati nr.101, datë 06.12.2017 Për krijimin dhe funksionimin e UVMS", ASCAL, Dok. nr.27. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[241] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.4, Manual për përdorimin e UVMS-Staf/Student", ASCAL, Dok. nr.25. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[242] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Fillor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[243] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | për personelin akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit[244]. Ndërsa DE dhe Drejtoria e Edukimit menaxhon nëpërmjet marrëveshjeve të përvitshme për organizimin e kohës së punës të stafit akademik[245]. | | | |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Nga takimi virtual me sekretarinë mësimore konstatuam se ajo ruan të gjithë dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në UVMS dhe në formatin e Regjistrit Themeltar të Studentëve dhe Regjistrin e Diplomimit. Çdo e dhënë koordinohet me sistemin qëndror kombëtar dhe studenti regjistrohet përfundimisht vetëm pasi i njihet numri i matrikullimit. | | | |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | Nëpërmjet sistemit digjital UVMS[246] rezulton se institucioni menaxhon sistemin e regjistrimeve, grafikun e provimeve online, hedhjen dhe ruajtjen e vlerësimit, fazën e paradiplomimit dhe diplomimit. Studentëve u jepen të dhënat e aksesit të llogarive individuale për regjistrimin përfundimtar në mënyrë që ata te aksesojnë atë në çdo kohë dhe të ndërveprojnë me personelin aktiv.<br>Sekretaria mësimore mban në sistem edhe të dhëna personale të studentëve si numra telefoni, adresa emaili dhe ruan kontakte të vazhdueshëm me studentët në raste njoftimesh. Të dhënat personale të tyre si datëlindja, qyteti i lindjes, adresa kontakti, etj. | | | |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | Rezulton se nëpërmjet UVMS institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ nëpërmjet aksesit që i jep dekanit dhe përgjegjësit të departamentit të kontrollojnë hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar.<br><br>*Rekomandohet hartimi i Raportit Vjetor të Veprimtarisë së DE në mënyrë që të garantojë monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ.* | | | |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Konstatojmë se në faqen zyrtare të internetit të UV janë publikuar të dhëna në lidhje me strukturën organizative, veprimtaritë, bazën ligjor si dhe njoftimet te ndryshme që lidhen me veprimtarinë akademike të UV, në gjuhën shqipe dhe angleze.<br><br>*Në faqen zyrtare të UV nuk gjendet informacion mbi programet e studimit, personelin akademik dhe planet mësimore.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

[244] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Procedure rekrutim stafi", ASCAL. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[245] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 4.4 Marrëveshje për organizimin e kohës së punës, 2018,", ASCAL, Dok. nr.36. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[246] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.4, Manual për përdorimin e UVMS-Staf/Student", ASCAL, Dok. nr.25. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| **Standardi IV.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Institucioni harton çdo fillim viti raportin financiar si pjesë e Raportit Vjetor të UV[247] ku deklarohen kostot e shpenzuara, të ardhurat dhe përcaktimi i tarifës së shkollimit si dhe kosto financiare mesatare për student[248].<br>Të ardhurat për mbarëvajtjen e programit të studimit burojnë nga buxheti i shtetit dhe nga tarifa e studentëve dhe *rezulton se institucioni nuk ka paraqitur një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe një plan financiar për mbështetjen dhe mbarëvajtjen financiare të programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsim Fillor.* |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij. | Rezulton se plani i financimit është i hartuar në rang intitucional. Ai përmban financimin e burimeve njerëzore në total për të gjithë programet e studimit që UV ofron, shërbimet operative për mirëmbajtjen, shpenzimet për studime e bursa, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara siç është edhe projekti Teavet i udhëhequr nga DE[249]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një | Nga shqyrtimi i RVB rezulton se për hartimin dhe miratimin e projekt buxhetit institucioni fillimisht merr parasysh nevojat e njësive bazë dhe kryesore të institucionit.<br>Raporti financiar realizohet në rang intitucional në mënyrë periodike e cili përban një pasqyrë të hollësishme financiare të të |

[247] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[248] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 4.6, Dokumente për menaxhimin e planit financiar", ASCAL, Dok. nr.38. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[249] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. | ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët si dhe ndarjen e burimeve financiare[250]. |
| **Kriteri 4.** Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. | Sipas Raporti Financiar[251] në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare jo vetëm të një viti akademik por bën një analizë krahasuese të zërave të buxhetit ndër vite dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme të financimit të insitítucionit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. | Bazuar në raportin financiar[252] insittucioni nëpërmjet analizës financiare të vitit akademik pararendës dhe atij aktual paraqet:<br>- Grandi kërkimor nga MARS<br>- Fondet që gjenerojnë nga të ardhurat e universitetit të cilat sigurohen nga tarifat e studimit dhe të ardhurat nga shërbime të tjera që institucioni ofron.<br><br>*Si rrjedhojë e rënies së ndjeshme, vit pas viti, të numrit të studentëve ky program studimi nuk paraqet qëndrueshmëri të madhe financiare për gjenerimin e të ardhurave për vitin akademik pasardhës.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

250 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
251 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
252 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Rezulton se institucioni zbaton procedurat për kriteret e pranimit dhe transferimit bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Asrimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" ne Udhëzim Nr.15, datë 26.05.2020, Disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr.10, datë 15.05.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar si dhe Udhëzim Nr. 17, datë 30.07.2019, Disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr.10, datë 15.05.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë".<br>Gjithashtu instritucioni bazohet tek propozimet e bëra nga njësitë bazë dhe të miratura nga Senati Akademik për kutotat[253] dhe kriteret[254]. |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Përpapa fillimit të çdo viti akademik institucioni me propozim nga DE dhe miratim nga Senati AKademik dhe MARS[255], harton kriteret dhe procedurat për hyrjen në programin e studimit Bachelor MAF, duke garantuar shance të barabarta për të gjithë kandidatët nëpërmjet shpërndarjes së kuotave për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare si dhe personat me aftësi të veçanta[256], etj. |
| **Kriteri 3.** Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të | Institucioni harton dhe publikon çdo vit kriteret e pranimit në programet e studimit që ofron UV[257].<br>Kriteret e pranimit dhe kuotat për secilin program studimi, transferimet e studimeve si dhe kriteret e vlerësimit të dijeve dhe |

[253] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.8, Kuotat e pranimit të studentëve në Programin e Ciklit të Parë Bachelor në (Mësuesi përArsimin Fillor)", ASCAL, Dok. nr.18. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[254] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.7, Kriteret e pranimit të studentëve në Programin e Studimit të Ciklit të Parë në DE dhe procedura e pranimit të studentëve të ciklit të parë Bachelor në (Mësuesi përArsimin Fillor)", ASCAL, Dok. nr.17. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[256] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.8, Kuotat e pranimit të studentëve në Programin e Ciklit të Parë Bachelor në (Mësuesi përArsimin Fillor)", ASCAL, Dok. nr.18. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[257] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.8, Kuotat e pranimit të studentëve në Programin e Ciklit të Parë Bachelor në (Mësuesi përArsimin Fillor)", ASCAL, Dok. nr.18. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | diplomimit përcaktohen në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor[258], Statutin[259] dhe Rregulloren e UV[260]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. | Rezulton se institucioni harton çdo vit akademik, me propozim të DE dhe miratim nga senati akademik kritere të veçanta sipas legjislacionit në fuqi, për përzgjedhjen e kandidatëve për student.<br><br>*Në faqen zyrtare të UV nuk rezulton të jenë të publikuara kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që institucioni ofron.* |
| **Kriteri 5.** Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. | Kriteret e pranimit dhe kuotat për secilin program studimi janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të MARS, si dhe të Maturës Shtetërore.<br>Ne kuotat e propozuara për vitin akademik 2018 -2019 për programin Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor institucioni ka propozuar 1 kuotë për kandidatët nga trojet dhe 1 per studentët e huaj[261]. |
| **Kriteri 6.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | Përpara pandemisë globale të Covid-19, në kuadër të ditëve të hapura për maturantët UV organizonte me shkollat e mesme të larta në vend takime informuese rreth UV dhe programeve të studimit që ai ofron.<br>Kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit, i cili informohet gjithashtu edhe nëpërmjet Fletë Palosjes Informuese për Studentët [262]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[258] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.1, Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"", ASCAL, Dok. nr.3 (shtojcw). Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[259] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[260] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[261] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.6, Kuotat e pranimit të studentëve në Programin e Ciklit të Parë Bachelor në (Mësuesi përArsimin Fillor)", ASCAL, Dok. nr.18. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[262] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 5.1, Fletë Palosje Informuese për Studentët", ASCAL, Dok. nr.39. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Rezulton se programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përban, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit.<br>Në fillim të vitit akademik studentët familjarizohen me materiale udhëzuese, si:<br>• Rregullorja e Programit të Studimit të Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor[263] përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin.<br>• Syllabuset[264] e moduleve përkatëse për çdo semester nga lektori i lëndës në të cilat jane te specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit të tyre.<br>• Kalendari akademik[265] në të cilin përcaktohen datat e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura si dhe diplomimet.<br>• Fletë Palosja Informuese për Studentët [266].<br><br>*Rekomandohet që institucioni të afishojë në këndet përkatëse të fakultetit, pranë departamenteve, në mjedise publike dhe gjithashtu të publikojë në faqen e webit të UV sipas fakulteteve përkatëse informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Nëpërmjet Rregullores e Programit të Studimit të Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor [267] dhe Rregulloren e DE[268] përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin, por nuk studenti gjen informacion të plotë mbi transferimet dhe kualifikimet. |

[263] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.1, Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"", ASCAL, Dok. nr.3 (shtojcw). Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[264] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.1- Syllabuset", ASCAL, Dok. nr.11. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[265] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.10, Kalendari akademik i Universitetit 2019-2020", ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[266] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 5.1, Fletë Palosje Informuese për Studentët", ASCAL, Dok. nr.39. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[267] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.1, Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"", ASCAL, Dok. nr.3 (shtojcw). Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[268] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.1, Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi pë rArsimin Fillor"", ASCAL, Dok. nr.3 (shtojcw). Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Ne syllabuset[269] e moduleve përkatëse për çdo semestër nga lektori i lëndës janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti në programin e studimit Mësuesi për Arsimin Fillor[270]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Në Rregulloren e Programit të Studimit të Mësuesi për Arsimin Fillor, seksioni 8.2/8.3, janë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit[271].<br><br>Studentët përfundojnë ciklit e studimeve të tyre bachelor me temë diplome me mesatare mbi 9 ose provim formimi[272], përcaktuar në Rregulloren e Programit të Studimit[273], Fondi i pyetjeve të provimit të formimit miratohet nga DE dhe u vihet në dispozicion studentëve në fillim të semestrit të dytë të vitit të tretë akademik[274]. |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Përpara pandemisë globale të Covid-19, në kuadër të ditëve të hapura për maturantët UV organizonte me shkollat e mesme të larta në vend takime informuese rreth UV dhe programeve të studimit që ai ofron.<br>Nga shqyrtimi i RVB dhe takimi online u informuam se institucioni në fillim të vitit të parë të studimeve DE organizon një takim informues me studentet. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

[269] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.1- Syllabuset", ASCAL, Dok. nr.11. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[270] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.1, Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi përArsimin Fillor"", ASCAL, Dok. nr.3 (shtojce). Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[271] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.1, Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi përArsimin Fillor"", ASCAL, Dok. nr.3 (shtojce). Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[272] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.10, Tezat e provimit përfundimtar për mbrojtjen e diplomës Bachelor në (Mësuesi përArsimin Fillor)", ASCAL, Dok. nr.31. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[273] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.1, Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi përArsimin Fillor"", ASCAL, Dok. nr.3 (shtojce). Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[274] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.9, Banka e pyetjeve për diplomimin e studentëve në arsimin fillor", ASCAL, Dok. nr.30. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. | Rezulton që nëpërmjet Statutit të UV[275] studentët mund të informohen për strukturën e institucionit, organizimin, njësitë dhe organet përgjegjëse për marrjen e informacionit për mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt tregut të punës.<br>Komunikimi i brendshëm mes studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore realizohet nëpërmjet UVMS[276].<br>Koordinatori i marrëdhënieve me studentët përcjell informacionin e nevojshëm në lidhje me syllabuset dhe format e vlerësimit për secilën, informacion në lidhje me frekuentimin, grafikun e provimeve, auditorët, etj[277]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Bazuar ne RVB rezulton se studenti mund te aksesoje infromacionin rreth programeve të studimit, lëndëve dhe veprimtarive formuese nëpërmjet njoftimeve dhe udhëzuesve që FSHH publikon, udhëzues dhe infromacione të printuara[278], në website-n e universitetit dhe në platformën UVMS. |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës. | Nga shqyrtimi i RVB dhe takimi online me Sektorin e Këshillimit të Studentëve dhe Alumnit rezulton se informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale drejt tregut të punës[279]. Gjithashtu Koordinatori për marrëdheniet me studentët, ofron për studentët këshillim për zhvillimin e karrierës[280]. |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Përpara pandemisë globale të Covid-19, çdo fillim viti akademik DE organizonte një takim informues me studentët e rinj gjatë së cilës orientoheshin me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës, leximin e orarit mësimor dhe përdorimin e sistemit informativ UVMS[281].<br>Nga vizita virtuale e mjedise edhe pse për shkak masave anti Covid-19 studentët nuk ishin prezent, konstatuam se në këndet e njoftimeve përkatëse të fakultetit nuk gjendej informacion fizik për studentët pasi këndet e njoftimeve po rinovoheshin. |
| **Kriteri 5** Informacioni në | Rezulton se nëpërmjet sistemit digjital UVMS, siç pohuan edhe |

275 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

276 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.6, Vendim Senati nr.101, datë 06.12.2017 Për krijimin dhe funksionimin e UVMS", ASCAL, Dok. nr.27. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

277 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.5, Emërimi i Koordinatorit për marrëdhëniet me studentët", ASCAL, Dok. nr.15. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

278 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 5.1, Fletë Palosje Informuese për Studentët", ASCAL, Dok. nr.39. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

279 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Fillor, f.64", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

280 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

281 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.6, Vendim Senati nr.101, datë 06.12.2017 Për krijimin dhe funksionimin e UVMS", ASCAL, Dok. nr.27. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| lidhje me programin e studimit mundësohet permes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance. | vetë studentët gjatë takimin online të zhvilluar në Zoom, arrijnë të marrin informacion lehtësisht të aksesueshëm edhe në distancë si dhe të ndërveprojnë gjatë realizimit të procesit mësimor. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi. | Nga shqyrtimi i Analizës Vjetore të UV[282]. kostatojmë se institucioni çdo vit akademik, paraqet pranë MASR-së raportet vjetore për veprimtarinë e kryer.<br>Raporti përmban informacione, përveç të tjerash edhe për numrin e studentëve actual dhe e të diplomuarve për çdo program studimi që UV ofron. |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | Nga shqyrtimi i RVB dhe Rregullorja e FSHH[283], rezulton se sekretaria mësimore është zyra, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të studentëve, për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti apo transkripti lidhur me studentët. Sekretaria Mësimore disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatre hyrëse dhe dalëse[284] etj. |
| **Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. | Nga takimi online me sekretarinë mësimore konstatuam se ajo administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themelar të studentëve, sipas legjislacionit ne fuqi. |
| **Kriteri 4.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të | Nga takimi virtual rezultoi se sekretaria mësimore e FSHH disponon statistika vjetore për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas progameve të studimit dhe cikleve të studimit. Gjithashtu ajo ruan të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit viti akademik, transferimet dhe |

282 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

283 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.5, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane, FSHH", ASCAL, Dok. nr.10. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

284 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Mesatarja ne hyrje dhe dalje", ASCAL. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| verifikueshme nga personat e autorizuar. | çregjistrimet, ecurinë akademike të studentit, numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik, si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen, përfshi edhe temën e diplomimit.<br>Sekretaria ruan dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student të programkit të studimit Bachelor në "Mësuesi Arsim Fillor" në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në sistemin e brendshem te informacit UVMS[285]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Nga shqyrtimi i Analizës Vjetore e UV rezulton se institucioni çdo vit akademik, paraqet pranë MASR-së raportet vjetore për veprimtarinë e kryer[286].<br>Sekretaria Mësimore gjithashtu disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notën mesatare hyrëse dhe dalëse[287].<br>Institucioni nuk ka paraqitur një raportin analitik periodik mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve.<br><br>*Rekomandohet që institucioni të hartoje raporte analitike periodike mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe për cilësisë e punësimit të tyre, ku, gjithashtu, të evidentojë masat e duhura që institucioni duhet të marrë në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë | Bazuar në Rregulloren e UV[288] dhe Statutin i UV[289] rezulton se institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik në ogranet kolegjiale të insitucionit:<br>Sipas Rregullores së UV studentët kanë të drejtë të kenë përfaqësues në:<br>- Senatin Akademik me dy anëtarë student duke respektur kuotat e përcaktuara nga legjislacioni ne fuqi. |

[285] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.4, Manual për përdorimin e UVMS-Staf/Student", ASCAL, Dok. nr.25. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[286] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[287] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Mesatarja ne hyrje dhe dalje", ASCAL. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[288] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[289] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| IAL-ve. | - Në Këshillin e Etikës;<br>Në vitin 2018 është gritur Këshillli Studentor i UV[290].<br>*Rekomandohet që Këshilli Studentor të hartojë rregulloren e tij të brendshme sipas legjislacionit në fuqi.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Institucioni është angazhuar të përfshijë studentët në vlerësimin e procesit akademik, nëpermjet ngritjes së instrumenteve matës për vlerësimin e mësimdhënies[291].<br>Ndërsa përsa i përket përfshirjes se studentëve në vendimmarrje e këshillim *rezulton se institucioni nuk disponon asnjë dokument që të vërtetojë pjesëmarrjen e studentëve në Senatin Akademik dhe Këshillin e Etikës.*<br><br>*Gjithashtu, në Grupin e punës ngritur nga NJSBC për hartimin e GVB[292] në kuadër të sigurimit të cilësisë për këtë program studimi konstatuam se nuk është përfshirë një përfaqësues i qeverisë studentore, bazuar në Manualin për "Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit", Ascal 2017.* |
| **Kriteri 3.** Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. | Rezulton se intitucioni gjatë hartimit të programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsim Fillor ka respektuar Ligjin Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe VKM nr. 41/2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", duke iu përmbajtur ngarkesës mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, jo më shume se 25 orë mësimore në javë[293].<br>Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh nga një student me kohë të plotë, është 60 kredite ose 1500 orë mësimore punë të studentit për çdo vit akademik. Gjatë vitit të parë studentët zhvillojë 600 orë në auditor dhe 815 orë punë të pavarur; gjatë vitit të dytë studentët zhvillojë 585 orë në auditor dhe 870 orë punë të pavarur dhe gjatë vitit të dytë studentët zhvillojë 577 orë në auditor dhe 888 orë punë të pavarur [294].<br><br>*Konstatohen mospëputhje të shpërndarjes së 1500 orëve mësimore punë të studentit, çdo vit akademik, në plan programin e Bachelor në Mësuesi Arsim Fillor.* |

[290] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Keshilli Studentor", ASCAL. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[291] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.1, Procedura e Analizës së Vlerësimit të Pyetësorit të Studentëve", ASCAL, Dok. nr.42. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[292] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Fillor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[293] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.4, Plani Mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E)", ASCAL, Dok. nr.9. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[294] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.4, Plani Mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E)", ASCAL, Dok. nr.9. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to. | Bazuar ne Statutin[295] dhe Rregulloren[296] e UV garantohet përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, *por intitucioni nuk ka paraqitur asnjë dokument që të pasqyrojë reflektimet dhe kontributin e tyre në mënyrë të drejtëpërdrejtë në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit.* |
| **Kriteri 5.** Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Nëpërmjet instrumentit matës për vlerësimin e mësimdhënies[297] studentëve u krijohet mundësia të japin mendim e tyre mbi cilësinë e zhvillimit të leksionit dhe aftësitë mësimdhënëse të pedagogut.<br><br>*Institucioni nuk ka paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë përfshirjen e studentëve në dhënie mendimi mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | X | | |

| **Standardi V.6**<br>**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. | Rezulton se institucioni paraqet procedura të qarta për informimin e studentëve nëpërmjet zyrave përkatëse si sekretaria mësimore, Drejtoria e Edukimit dhe Koordinatori për marrëdhëniet me studentët, i cili luan një rol të rëndësishëm në informimin, këshillimin dhe orientimin e studentëve. Koordinatori asiston sudentët në krijimin e një plan studimi individual dhe kryen verifikimet e domosdoshme për detyrimet që studenti duhet të shlyej[298]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për | Konstatojmë që nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të UV studentët kanë mundësi të informohen edhe në distancë[299] për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave online, |

[295] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[296] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[298] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.2, Vendim për Miratimin e Rregullores së DE", ASCAL, Dok. nr.7. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[299] https://univlora.edu.al/

| | |
|---|---|
| informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim. Gjithashtu informacione më të detajuara për profilin e tyre personal, studentët mund te gjejnë në plarformën UVMS[300], ku mund të informohen për provimet, vlerësimet e vazhduara dhe vlerësimet përfundimtare. |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Përmes Sektorit të Këshillimit të Studentëve dhe Alumn-it, kandidatët për student, studentët dhe alumni marrin infomacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës se tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rrumbullakëta, takimeve të studenteve që institucioni organizon.<br>Gjithashtu ajo ofron informacion për bursa, konferenca studimore, informacion në lidhje me mobilitetet dhe progamet e shkëmbimeve jashtë vendit.<br>Institucioni ka në traditë të tij pjesëmarrjen në panairin e përvitshëm Work & Study të organizuar nga MARS[301].<br>Ndërsa, praktikat profesionale zhvillohen në institucione shtetërore, sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti i edukimit[302]. |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | Bazur në rishikimin e RVB konstatojmë se institucioni disponon të dhena për diplomimin e studentëve por nuk disponon të dhëna zyrtare për punesimin dhe cilësinë e punësimit të studentëve të këtij program studimi[303].<br><br>*Rekomandohet që Sektori i Këshillimit të Studentëve dhe Alumn-it të aplikojë makanizma të ndryshme për gjurmimin e studentëve pas diplomimit si dhe të ngrejë instrumentet e duhura për mbledhjen dhe përpunim e të dhënave për cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe t'ua vë ato në dispozicion organeve drejtuese përkatëse.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

300 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.4, Manual për përdorimin e UVMS-Staf/Student", ASCAL, Dok. nr.25. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

301 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 5.3, Raport Panairi Work & Study", ASCAL, Dok. nr.41. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

302 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Dosja e praktikes se studenteve", ASCAL. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

303 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Fillor, Tabela 23", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT "BACHELOR"

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisët** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Bazuar në Ligjin nr.80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" rezulton se institucioni ka hartuar politika dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë[304]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Rezulton se në vitin 2016 institucioni ka ngritur Njësinë e Vlerësimit dhe Sigurisë të Brendshme të Cilësisë së institucionit[305]<br>Konstatojmë se insitutcioni është ende në fazën e hartimin të një draft rregullore për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.<br><br>*Rekomandohet hartimi i një plani strategjik për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë se insitucionit, ku të përfshihen gjithashtu studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. | Konstatojmë se institucioni përdor disa instrumente matës për sigurimin e cilësisë siç janë vlerësimet për performancën e stafit akademik[306] dhe pyetësor për studentët[307] për matjen e cilësisë së mësimdhënies.<br><br>*Rezulton se institucioni nuk ka paraqitur asnjë dokument që të faktojë përdorim e instrumenteve të duhura për sigurimin e cilësisë përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e | Rezulton se institucioni ka hartuar politika dhe procedura të qarta dhe periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron. Disa nga këto procedura |

[304] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[305] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.1", Vendim i Senatit Akademik të UT "Ismail Qemali, Vlorë, nr.84, datë 12.12.2016 Për ngritjen e NJSBCVI", ASCAL, Dok. nr.22. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[306] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.2, Miratimi i formularit të vlerësimit për matjen e performancës të stafit akademik", ASCAL, Dok. nr.43. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[307] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.1, Procedura e Analizës së Vlerësimit të Pyetësorit të Studentëve", ASCAL, Dok. nr.42. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit. | periodike janë:<br>- Plan masash për përmirësimin e cilësisë së Departamentit[308];<br>- Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit (2017 -2022)[309];<br>- Raporti vetor i UV[310];<br>- Instrumentët matës për vlerësimin e stafit akademik nga ana e studentëve[311] dhe pyetësor për studentët[312] për cilësinë e mësimdhënies:<br>- Strategjia e kërkimit shkencor nga ana e institucionit[313]. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë. | Konstatojmë se institucioni ka ngritur në rang njësie bazë grupin e punës për rritjen e cilësisë [314]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të | Rezulton se institucioni harton çdo vit akademik Raportin Vjetor[315] në rang institucioni dhe Plani Stategjik i Departamentit të Edukimit[316] paraqitet një analizë për përdorimin e mekanizmave për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë. |

[308] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.4, Plan masash për përmirësimin e cilësisë së Departamentit", ASCAL, Dok. nr.45. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[309] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.3, Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit (2017 -2022)", ASCAL, Dok. nr.8. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[310] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[311] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.3 Miratimi i formularit të vlerësimit për matjen e performancës së stafit ndihmës-akademik,", ASCAL, Dok. nr.44. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[312] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.1, Procedura e Analizës së Vlerësimit të Pyetësorit të Studentëve", ASCAL, Dok. nr.42. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[313] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 4.3 Shkresa për miratimin e Strategjisë së kërkimit shkencor 2017-2022,", ASCAL, Dok. nr.35. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[314] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.5, Ngritja e grupit të punës së cilësisë, DE", ASCAL, Dok. nr.46. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[315] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[316] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.3, Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit (2017 -2022)", ASCAL, Dok. nr.8. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| ciklit të parë. | |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. | Nga shqyrtimi i Raportit Vjetor dhe të Vlerësimit të Brendshëm në rang insitucional[317] dhe Planit të masave për përmirësimin e departamentit[318] rezulton se institucioni përdor instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. |
| **Kriteri 4.** Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | Nëpërmjet instrumentave matës për vlerësimin e stafit[319] dhe pyetësor për studentët[320], studentëve u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës.<br>Pas shqyrtimin i Procedurës për Analizën e Vlerësimit të Pyetësorit të Studentëve[321]" rezulton se të dhënat e rezultateve u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. |
| **Kriteri 5.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. | Institucioni harton çdo vit Raportin Vjetor por në të nuk trajtohen rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.<br><br>*Rekomandohet hartimin i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm Insitucional, i cili duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Vlerësimi i brendshëm i programit të | Nga shqyrtimi i RVB rezuton se çdo vit akademik, në mënyrë periodike, hartohet Raportin Vjetor i Institucionitt[322] si dhe |

[317] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[318] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.4, Plan masash për përmirësimin e cilësisë së Departamentit", ASCAL, Dok. nr.45. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[319] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.2, Miratimi i formularit të vlerësimit për matjen e performancës të stafit akademik", ASCAL, Dok. nr.43. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[320] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca L, Raport mbi rezultatet e pyetsorit studentor për Vitin akademik 2018 -2019", ASCAL, Dok. nr.60. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[321] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.1, Procedura e Analizës së Vlerësimit të Pyetësorit të Studentëve", ASCAL, Dok. nr.42. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[322] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike. | Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit[323], ku pasqyrohen objektikat dhe synimet për departamentin, studentëte dhe kërkimin shkencor.<br>*Konstatojmë se NJSBCVI harton raportin e analizës së pyetësorëve të studentëve[324] për mësimdhënien, por nuk ka paraqitur asnjë dokument që të faktojë se kryen në mënyrë periodike vlerësimin e brendshëm të këtij program studimi.* |
| **Kriteri 2.** Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. | Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme si:<br>- Raporti Vjetor i UV [325];<br>- Të dhënat nga instrumentet matës për perfomancen e pedagogut dhe cilësisë së mësimdhënies[326];<br>- Plan masash për përmirësimin e cilësisë së Departamentit[327];<br>- Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit [328]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo | Rezulton se institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta, si:<br>• vlerësim i cilësisë së mësimdhënies[329];<br>• vlerësim i performancës së pedagogut[330];<br><br>*Institucioni nuk ka paraqitur asnjë dokument që të faktojë realizimin e vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.* |

[323] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.3, Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit (2017 -2022)", ASCAL, Dok. nr.8. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[324] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.1, Procedura e Analizës së Vlerësimit të Pyetësorit të Studentëve", ASCAL, Dok. nr.42. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[325] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[326] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.1, Procedura e Analizës së Vlerësimit të Pyetësorit të Studentëve", ASCAL, Dok. nr.42. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[327] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.4, Plan masash për përmirësimin e cilësisë së Departamentit", ASCAL, Dok. nr.45. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[328] U Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.3, Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit (2017 -2022)", ASCAL, Dok. nr.8. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[329] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.6, Ngirtja e grupit të punës për përmirësimin e pyetësorit të sudentënve"", ASCAL, Dok. nr.47. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[330] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.2, Miratimi i formularit të vlerësimit për matjen e performancës të stafit akademik", ASCAL, Dok. nr.43. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera. | |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e dministrative, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | Institucioni realizon në mënyrë periodike dy pyetësore:<br>1) Për matjen e perfomancës së stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi[331],<br>2) Për cilësinë e mësimdhënies[332].<br><br>*Rekomandohet që institucioni të zhvillojë sondazhe ose/dhe intervista të alumnit, të personelit akademik e ndihmësakademik si dhe bashkëpunëtorëve të tjerë që kontribuojnë në realizimin e këtij program studim apo/dhe që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Rezulton se departamenti ka hartuar Strategjinë për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit[333] dhe ka ngritur njësinë e sigurimit të cilësisë brenda deparatmentit[334] por institucioni nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokument ku të paraqitet veprimtaria e këtij grupi në shërbim të përmirësimit të vazhduar të cilësisë së programit të studimit.<br><br>*Rekomandohet që institucioni të garantojë politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë ku të përfshihen aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni | Rezulton se institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra |

[331] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.2, Miratimi i formularit të vlerësimit për matjen e performancës të stafit akademik", ASCAL, Dok. nr.43. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[332] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.1, Procedura e Analizës së Vlerësimit të Pyetësorit të Studentëve", ASCAL, Dok. nr.42. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[333] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.3, Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit (2017 -2022)", ASCAL, Dok. nr.8. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[334] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.5, Ngritja e grupit të punës së cilësisë, DE", ASCAL, Dok. nr.46. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar në GVB për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të programeve të studimit[335], ngritja e grupit të punës së cilësisë, DE[336], si dhe ngritja e grupeve mësimore në DE[337] duke garantuar kështu ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit. | Rezulton se anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit janë të përfshirë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit në rang departamenti dhe fakulteti.<br>Vlerësimi i cilësisë se Departamentit të Edukimit realizohet nga grupi i punë i ngitur në nivel njësie bazë, i përbërë nga 6 anëtar[338]. |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | Bazuar në Rregulloren e UV[339], Statutin e UV[340] si dhe Rregulloren e Etikës së Kërkimit Shkencor dhe Publikimit në UV[341] rezulton se institucioni rregullon integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve. |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e | Rezulton se nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit që UV ka me institucione të rëndësishme ndërkombëtare[342]si: Universiteti i Leçes, Barit, Mesinës, Perugias, Kozencës (Itali), Liezhit (Belgjikë), Kretës (Greqi), Universiteti i Talin-it (Estoni), Universiteti i Turku-t (Finlandë) Universiteti i Vigo-s, Valencia -s (Spanjë), Universiteti i Nish-it (Serbi), Universiteti i |

[335] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Fillor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[336] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.5, Ngritja e grupit të punës së cilësisë, DE", ASCAL, Dok. nr.46. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[337] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.3", Vendim nr.23, datë 17.01.2017 i DE Për ngritjen e grupeve mësimore në DE", ASCAL, Dok. nr.13. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[338] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.5, Ngritja e grupit të punës së cilësisë, DE", ASCAL, Dok. nr.46. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[339] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[340] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[341] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca F, Rregullore e Etikës së Kërkimit Shkencor dhe Publikimit në UV", ASCAL, Dok. nr.54. Parë në Janar 2021, gjendet
[342] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca D, Strategjia e Ndërkombëtarizimit", ASCAL, Dok. nr.52. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Shkencave Natyrore Sofje (Bullgari), Universiteti i Timisoharës (Rumani), Universiteti i Alesundit (Norvegji) etj.[343] ku pedagogët e Departamentit të Edukimit kanë shkëmbyer përvoja profesionale. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | Rezulton se institucioni ka bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. në faqen zyrtare të UV, Statutin, Rregullen, të gjithë vendimet e marra nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. |
| **Kriteri 2.** Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | *Rezulton se institucioni nuk ka paraqitur asnjë dokument që të faktojë publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit.* |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | Konstatojmë se instiutcioni ka hartuar në rang njësie bazë Planin e Masave[344] dhe Stategjinë për Zhvillimin e Departamentit[345], të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara për departamentin, studentet dhe aktivitetin kërkimor-shkencor të stafit akdemik dhe studentor. |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e | Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë nëpërmjet Planit të Masave të marra nga departamenti[346] dhe |

[343] Lista e plote e marreveshjeve nder institucionale: https://univlora.edu.al/sektori-projekteve/marreveshje-nderinstitucionale/

[344] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.4, Plan masash për përmirësimin e cilësisë së Departamentit", ASCAL, Dok. nr.45. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[345] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.3, Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit (2017 -2022)", ASCAL, Dok. nr.8. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[346] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.4, Plan masash për përmirësimin e cilësisë së Departamentit", ASCAL, Dok. nr.45. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | përmirësimin e vazhdueshëm të instrumenteve të vlerësimit për përmirësimin e mësimdhënies[347]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Nga shqyrtimi i RVB dhe diskutimet e realizuara nga takimet online me NJSBC rezultoi se institucioni organizon takime periodike me stafin akademik, ndihmës dhe studentët për t'i informuar për arritjet dhe rekomandimet që duhet të plotesojë institucioni për rritjen e cilësisë së institucionit në tërësi dhe programeve të studimit, në veçanti. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

[347] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.6. Ngirtja e grupit të punës për përmirësimin e pyetësorit të sudentënve"", ASCAL, Dok. nr.47. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

**<u>Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor" të Institucionit të Arsimit të Lartë "Ismail Qemali" Vlorë.</u>**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi Bachelor në "Mësuesi për Arsimin fillor" që zbatohet nga Departamenti i Edukimit (DE) të Fakultetit të Shkencave Humane (FSHH) pranë Universitetit "Ismail Qemali' Vlorë (UV) ka rreth 22 vite akademike që zhvillohet në këtë institucion.

2. Programi Bachelor në "Mësuesi për Arsimin fillor" zbaton akte normative konform ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore të MASR, por dhe ato të hartuara nga vetë UV.

3. UV ka infrastrukturë fizike, ndihmëse, plaftormë online që lehtëson zbatimin e programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin fillor", por dhe kërkesat e nevojat e studentëve. Rezulton se nëpërmjet UVMS institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ.

4. Fakulteti i Edukimit ka kapacitet infrastruktoror dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve të programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor", duke përmbushur kështu standardet e kapacitetit infasrtukturor për student.

5. Institucioni ka realiuar marrëveshje bashkepunimi me Bashkinë e Vlorës për krijimin e kushteve për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike të cilat janë thelbësore për ketë program studimi.

6. Institucioni harton çdo vit akademik Raportin Vjetor në rang institucioni dhe Plani Stategjik i Departamentit të Edukimit paraqitet një analizë për përdorimin e mekanizmave për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.

**Pika të dobta**

1. Konstatohen mospëputhje të shpërndarjes së 1500 orëve mësimore punë të studentit, çdo vit akademik, në plan programin e Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor".

2. Rezulton se institucioni nuk disponin asnjë laborator të teknologjisë së infomacionit në rang fakulteti e universiteti.

3. Institucioni nuk disponon një rregullore të brendshme për funksionimin e Këshillit Studentor.

4. Rezulton se institucioni nuk disponon instrumente të qarta për gjurmimin e studentëve pas diplomimit si dhe për mbledhjen dhe përpunim e të dhënave për cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit.

5. Departamenti nuk ka një studim të mirëfilltë të tregut të punës, i cili të përditësohet në mënyrë periodike nga Departamenti i Edukimit

6. Institucioni nuk disponon një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor.

**Rekomandime**

1. Rekomandohet te rishikohet shpërndarja e orëve mësimore punë të studentit, çdo vit akademik, në plan programin e Bachelor në "Mësuesi Arsimin Fillor", sipas legjislacionit ne fuqi

2. Rekomandohet që institucioni të hartojë raporte analitike periodike mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve ku të evidentojë masat e duhura që institucioni duhet të marrë në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.

3. Rekomandohet që institucioni të sigurojë për studentët të paktën një laborator të teknologjisë së infomacionit të pajisur me programe profesionale në shërbim të programit të studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor".

4. Rekomandohet që Këshilli Studentor të hartojë rregulloren e tij të brendshme sipas legjislacionit në fuqi.

5. Rekomandohet që Sektori i Këshillimit të Studentëve dhe Alumn-it të hartojë strategji dhe te aplikojë makanizma të ndryshëm për gjurmimin e studentëve pas diplomimit si dhe të ngrejë instrumentet e duhura për mbledhjen dhe përpunim e të dhënave për cilësinë e punësimit të studentëve të këtij program studimi.

6. Rekomandohet që Departamenti të zhvillojë analiza të mirëfillta të tregut të punës në mënryë që të rrisë numrin e studentëve në këtë program.

7. Rekomandojmë që institucioni të hartojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor.

**Conclusions of the Evaluation of the study program "Bachelor" in "Teacher for Primary Education" of the Higher Education Institution "Ismail Qemali" Vlora.**

**Strengths and affirmations**

1. The Bachelor program in "Teacher for Primary Education" implemented by the Department of Education (DE) of the Faculty of Humanities (FH) at the University "Ismail Qemali 'Vlora (UV) has been taking place in this institution, for about 22 academic years.

2. The Bachelor program in "Teacher for Primary Education" implements normative acts in accordance with the law of higher education and bylaws of MoESY, but also those drafted by UV itself.

3. UV has physical infrastructure, auxiliary, online platform that facilitates the implementation of the program, but also the requirements and needs of students. It turns out that through UVMS the institution guarantees real-time monitoring of academic and administrative activity.

4. The Faculty of Education has infrastructural capacity and full space for accommodation of students of the Bachelor program in "Teacher for Primary Education", thus meeting the standards of infrastructural capacity per student.

5. The institution has realized a cooperation agreement with the Municipality of Vlora for the creation of conditions for the development of professional practices and other practical activities which are essential for this study program.

6. The institution compiles every academic year the Annual Report at the level of the institution and the Strategic Plan of the Department of Education presents an analysis of the use of mechanisms for the review, approval and occasional supervision of undergraduate study programs.

**Weak points**

1. Discrepancies are found in the distribution of 1500 teaching hours of student work, each academic year, in the Bachelor program in "Teacher for Primary Education".

2. It turns out that the institution did not have any information technology laboratories at the faculty and university level.

3. The institution does not have an internal regulation for the functioning of the Student Council.

4. It turns out that the institution does not have clear instruments for tracking students after graduation as well as for collecting and processing data on the quality of employment of students in this study program.

5. The Department does not have a proper labor market study, which is periodically updated by the Department of Education.

6. The institution does not have a detailed plan for increasing the number of library items in support of the Bachelor program in Primary Education Teacher.

**Recommendations**

1. It is recommended to review the distribution of student working hours, every academic year, in the Bachelor program in "Teacher for Primary Education", according to the legislation in force.

2. It is recommended that the institution compiles periodic analytical reports on the quality of incoming and outgoing students where it identifies the appropriate measures that the institution should take towards improving these indicators.

3. It is recommended that the institution provides for students at least one information technology laboratory equipped with professional programs in service of the Bachelor study program in "Teacher for Primary Education".

4. It is recommended that the Student Council drafts its internal regulations according to the legislation in force.

5. It is recommended that the Student Counseling and Alumn Sector develop strategies and apply various mechanisms for tracking students after graduation as well as establish appropriate tools for collecting and processing data on the quality of student employment of this study program.

6. It is recommended that the Department conduct thorough labor market analysis in order to increase the number of students in this program.

7. It is recommended that the institution draw up a detailed plan for increasing the number of library items to support the Bachelor program in Primary Education Teacher.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | X | |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | X | |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE | | | X | |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | X | |